ISSN 1857-6443

## Artistët do të paguhen ndryshe

FAQE 2

## Rroga minimale 12.000 denarë

FAQE 2

## Në luftë me zjarret

FAQE 5

## Vera shton lëvizjet në Bllatë

FAQE 7


www.koha.mk

# Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3140 • E shtunë-e diel 5-6 gusht 2017 | 15 DEN




## KOHA për enigma
FAQE 11-14



# Edhe shkenca në pazaret politike

*Shkup, 4 gusht* - Një pjesë e marrëveshjes politike mes BDI-së dhe ASH-ët që u dakorduan një muaj më parë sa i përket ndarjes së eshalonit të tretë atë të drejtorive, të premten në media ka dalë lista e drejtorive që do i takojnë ASH. Ishte TV21 që publikoi këtë listën ndërsa e njëjta u konfirmua për gazetën KOHA edhe nga zyrtarë të lartë të LR-PDSH-së, por që deshën të mbeten anonim për publikun. Sa i përket ndarjes së drejtorive bie në sy edhe Instituti për Trashëgimi Kulturore të Shqiptarëve në Shkup që sipas marrëveshjes - do ti takojë LR-PDSH-së. Nga kjo parti e konfirmojnë këtë, por nuk japin detaje se si do të ndodhë kjo kur drejtori aktual ka mandat të rregullt pesëvjeçar. “Po, në listë e kemi edhe Institutin për Trashëgimi Kulturore, por se si do të rregullohet kjo punë, nuk i dimë ende...

Faqe 3

Ndryshimet klimatike po dëmtojnë prodhimtarinë

# Parashikime të zeza për bujqësinë



Kursimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ujit, shfrytëzimi i mbetjeve të prodhimtarisë bujqësore për biodizel, përpunim i reduktuar i tokës, si dhe përdorimi i rrjeteve mbrojtëse janë vetëm disa nga masat për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që ju sugjerohen bujqve

FAQE 4

GLOBI

## Rënie dramatike e spermatozoideve tek meshkujt perëndimorë



Në spermën e meshkujve nga vendet e zhvilluara në Evropë, në Amerikën e Veriut, në Australi dhe Zelandën e Re gjenden gjithnjë e më pak spermatozoid. Sipas studiuesve shkaku për këtë mund të...

FAQE 15

GLOBI

## Refugjatët po dhunohen nga policët

FAQE 15

## Trump do të përgjysmojë dhënien e Green Cards

FAQE 15







# Emërohen mbi 20 drejtorë të rinj të institucioneve shëndetësore

*Shkup, 4 gusht* - Ministria e Shëndetësisë njoftoi se janë emëruar drejtorë të rinj në disa institucione shëndetësore publike. Drejtor i ri i Institutit për mjekësi transfuzioni është dr.Koço Dimitrovski, i Spitalit klinik - dr.Zoran Llazarov, i Spitalit të përgjithshëm Kavadar - dr.Dime Kocev, i Spitalit të përgjithshëm Veles - dr.Dimitar Strovjanski, i Klinikës universitare për kirurgji digjestive - dr.Zoran Karaxhov, i Klinikës universitare për sëmundje të fëmijëve - dr.Katerina Stavriq, i Klinikës universitare të psikiatrisë - dr.Stojan Bajraktarov, i Klinikës universitare të neurokirurgjisë - dr.Vlladimir Rendevski, i Klinikës universitare të kirurgjisë maksilofaciale - dr.Sllave Naumovski, i Klinikës për pulmologji - dr.Dejan Dikiq, i Klinikës për kirurgji plastike - dr.Sofija Pejkova, i Klinikës universitare torakale dhe vaskulare - dr.Nexhati Jakupi, dhe i Klinikës për vesh, hundë dhe fyt - dr.Jane Netkovski. Për drejtor të Entit për mjekësi fizikale dhe rehabilitim në Shkup është emëruar dr.Maja Manolleva, Shtëpisë së Shëndetit - Manastir - dr.Vesna Spirovska, Shtëpisë së Shëndetit në Kriva Pallankë - dr.Branko Stamenkovski, Shtëpisë së Shëndetit Kratovë - dr.Lupço Bojaxhiev, Shtëpisë së Shëndetit në Vinicë - dr.Venco Vijunov, e Shtëpisë së Shëndetit në Probishtip - dr.Goce Nedellkovski, Shtëpisë së Shëndetit në Strumicë - dr.Ljubica Miteva dhe Entit të dëgjimit, të folurit dhe të shprehurit në Manastir - dr.Divna Najdovska. Për drejtor i Spitalit në Gostivar u emërua dr.Gojart Sulejmani, si dhe në Shtëpinë e shëndetit në Shtip u emërua dr.Snezhana Trajkovska. Ministria e Shëndetësisë informon edhe se është shkarkuar drejtori ekonomik i Klinikës për gastroenterohepatologji.

# Qeveria vendosi: Rroga minimale 12.000 denarë

*Shkup, 4 gusht* - Qeveria e Republikës së Maqedonisë të enjten mbrëma në seancën e 19-të e ka miratuar propozim-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrogë minimale dhe me këtë e filloi procedurën ligjore për rritje të rrogës minimale në nivel prej 12.000 denarëve. Do të mundësohet pagesë e vlerës së njëjtë të rrogës minimale për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë, të cilët kanë rrogë minimale, ndërsa do të mundësohet edhe mbështetje financiare për firmat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë që ta paguajnë rrogën minimale më të lartë të kontraktuar. Siç kumtoi pres-shërbimi qeveritar, ndryshimet e miratuara të propozim ligjit, Qeveria gjatë ditës menjëherë do t'i dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në shqyrtim dhe miratim.

## Ligji i Kulturës sërish në Parlament

**Me paketën e pesë propozimeve për ndryshime dhe plotësime në Ligjin e Kulturës që pritet të shqyrtohet Parlamenti me procedurë të përshpejtuar, arsyetohen kërkesat e Ministrisë së Kulturës, për të rishikuar shumën e pensioneve të artistëve, fitues të çmimeve kombëtare, rregulla të reja për menaxhimin e institucione të kulturës, e të tjera. Ndryshimet janë kërkuar që të miratohen sa më shpejt në mënyrë që të shmangen shpenzimet e tepërta për pensionet dhe të vihen nën kontroll puna e drejtorëve**



# Artistët do të paguhen ndryshe

Koha — Evis HALILI

*Shkup, 4 gusht* - Ndryshimet që pësoi Ligji i Kulturës në vitin 2011 dhe ato që pasuan tre vjet më pas - në 2014, do të shfuqizohen. Me paketën e pesë propozimeve për ndryshime dhe plotësime në Ligjin e Kulturës që pritet të shqyrtohet nga Parlamenti me procedurë të përshpejtuar, arsyetohen kërkesat e Ministrisë së Kulturës, për të rishikuar shumën e pensioneve të artistëve, fitues të çmimeve kombëtare, formën e menaxhimit të institucione të kulturës, e të tjera. Të parat në listën e propozimeve të ministrit të Kulturës, Robert Allagjozovski, janë pensionet e artistëve dhe punonjësve të tjerë të artit dhe kulturës, përllogaritja e të cilave do të bëhet në mënyrë të atillë që të mos e tejkalojë vlerën tavan prej 38.500 denarë - propozim ky që vlen për mbi 60 artistë, fitues të tre çmimeve shtetërore: "11 Tetori", "Shën Klimenti i Ohrit" dhe "23 Tetori", përllogaritja e pensioneve që sipas Ligjit në fuqi - ka arritur edhe deri në më shumë se 47 mijë denarë. Po ashtu, pritet që listës së përfituesve të pensioneve t'i shtohen edhe ata artistë që çmimin "11 Tetori" e kanë marrë gjatë viteve 1959-1987, përkatësisht të krijohet baza ligjore që edhe ata të kenë trajtim të barabartë me fituesit e tjerë të këtij çmimi.

"Duke pasur parasysh faktin se janë plotësuar kushtet dhe se nuk bëhet fjalë për ndonjë ligj voluminoz dhe të komplikuar dhe me miratimin e tij do të reduktohen detyrimet financiare për likuidimin e kompensimeve për pensionistët, fitues të çmimeve kombëtare të kulturës, dhe të sigurohet zbatimi sa më efikas i Ligjit në pjesën e punës së drejtorëve të institucioneve nacionale dhe efikasitet më i madh në inspektim, sugjerojmë që Propozimi për ligjin të miratohet me procedurë të përshpejtuar", ka kërkuar ministri Allagjozovski. Ndryshime të tjera ligjore, që do të shfuqizojnë ato të tre viteve më parë janë edhe ato që lidhen me nënshkrimin e kontratave menaxheriale mes drejtorëve dhe ministrit të kulturës, pas emërimit të tyre. Kjo dispozitë do të shfuqizohet, pasi sipas analizës së bërë nuk ka sjellë efekte pozitive, por ka krijuar pengesa për monitorimin efikas të punës së drejtorëve, por edhe marrjes së masave ndaj tyre, në rastet e shkeljeve dhe abuzimeve prej tyre. Po ashtu do të ndryshojë edhe një tjetër pikë e Ligjit, sipas së cilës çdo gjashtë muaj drejtorët e institucioneve duhet t'i raportojnë ministrit për punën e bërë, dhe po gjashtë muaj kanë në dispozicion për të përmirësuar mangësitë apo vërejtjet eventuale. Kjo dispozitë do të shfuqizohet, pasi Ministria vlerëson se afati i këtillë ligjor mundëson që mangësitë të thellohen dhe të reflektohen negativisht në punën e institucionit. Pas raportimit të drejtorit është ministri ai që do të vendosë afatin për përmirësimin e të metave, varësisht rastit dhe problemit.

Në ndryshimet e propozuara të Ligjit për kulturë po ashtu kërkohet edhe të ndëshkohen drejtorët dhe personat përgjegjës nëpër institucione nëse nuk i binden kërkesave të inspektorëve të kulturës për të siguruar të gjitha dokumentacionin që pasqyron gjendjen e përgjithshme të institucionit që drejtojnë në rastet e inspektimit dhe kontrolleve mbikëqyrëse. Paketa me propozimet do të shqyrtohet nga Komisioni i Kulturës përpara se të miratohet nga Parlamenti.

### Grupi punues për përpunimin e Strategjisë nacionale për kulturë 2018-2022

Ministri i Kulturës, Robert Alagjozovski formoi grup punues për përpunimin e projekt-strategjisë nacionale për zhvillim të kulturës për periudhën e vitit 2018-2022, i cili sot mbajti takim konstruktiv, kumtoi Ministria e Kulturës. Në përbërjen e grupit punues janë Zllatko Teoedosieski, kritik letrar dhe këshilltar - kurator (koordinues i grupit punues), Iskra Geshoska, punonjëse kulture nga "Jadro" - Asociacioni i skenës së pavarur kulturore, dr. Valentina Poceska, këshilltare-konservatore, mr. Valmira Istrefi, studime urbane, mr. Xhevdet Jashari, aktor dhe ligjërues në Fakultetin për art dramatik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Magdalena Dikovska, nëpunëse e kabinetit për punë juridike në Ministrinë e Kulturës dhe Goce Bozhurski, këshilltar në Sektorin për arte vizuale, arkitekturë dhe dizajn në Ministrinë e Kulturës. Puna e Grupit të punës është që të përpunohet koncepti dhe projekt-strategjia, të cilët do të jenë të disponueshëm deri te ministri i Kulturës dhe do të jenë objekt i debatit publik me të gjitha palët e interesuara në periudhën në vijim, deri në sjelljen e strategjisë në fund të vitit 2017. Siç informon Ministria, në takimin konstituiv, gjatë formimit të ekspertëve të përzgjedhur me detyrat konkrete dhe kompetenca, ministri Allagjozovski theksoi se nga debati publik pret investim serioz nga të gjitha palët e cenueshme në të gjitha veprimet kulturore, sepse kjo do të thotë kontribut i aktorëve kulturorë në interes personal, por edhe në interes të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

# Punëdhënësit t'i respektojnë rekomandimet për mbrojtjen e punëtorëve



*Kumanovë, 4 gusht* - Punëdhënësit t'i respektojnë rekomandimet e dhëna prej ministrive kompetente për mbrojtjen e punëtorëve për shkak të kushteve të pavolitshme të motit, gjegjësisht fazën e shpallur portokalli, porositi sot ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska, e cila mori pjesë në shënimin e fillimit të rikonstruimit të ish "Shtëpisë së pionierëve" në kopsht. "Prej sot deri të dielën është faza portokalli. Ministria e Shëndetësisë publikoi, ne ndërmorëm, i informuam në Inspektoratin shtetëror të punës, përsëri publikuam kumtesë se të gjithë punëdhënësit janë të obliguar t'i respektojnë rekomandimet. Dhamë edhe telefon celular dhe i lus të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë të denoncojnë në atë telefon dhe inspektorët kujdestarë do të jenë në terren gjatë gjithë fundjavës", deklaroi ministrja Carovska. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve, nëse deri më tani ka pasur ankesa, tha se deri tek ajo nuk ka arritur, por shfaqi bindje se kanë arritur ankesa në Inspektoratin shtetëror të punës.

"E dini se shumë vështirë punëdhënësit i respektojnë dispozitat, por është shumë e rëndësishme, punëtorë të shëndoshë të cilët janë të aftë për punë i nevojiten Maqedonisë dhe prandaj është e rëndësishme t'i mbrojmë në momente të tilla, të respektohen rekomandimet është rekomandimi im si ministre", theksoi Carovska. *(R.K)*



Ndërkohë, në opinion ka pasur zëra kritik menjëherë pas publikimit të këtij lajmi në drejtimin se, drejtori i ITKSH nuk është post politik, por ka mandat të rregullt pesëvjeçar me konkurs publik



Partitë shqiptare ndajnë drejtoritë

# Edhe shkenca në pazaret politike

**Sa i përket ndarjes së drejtorive, bie në sy edhe Instituti për Trashëgimi Kulturore të Shqiptarëve në Shkup që sipas marrëveshjes - do ti takojë LR PDSH-së. Nga kjo parti e konfirmojnë këtë, por nuk japin detaje se si do të ndodhë kjo kur drejtori aktual ka mandat të rregullt pesëvjeçar dhe emërohet me konkurs**

Koha Fatos RUSHITI



## ITSHKSH: TË NDËRPRITEN PAZARLLËQET E PISTA PARTIAKE-POLITIKE

Lidhur me informacionet se edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve është vënë në tryezën e ndarjes së posteve qeveritare, ashpër ka reaguar ITSHK. Në reagim e këtij Instituti thuhet se"partitë politike, si misionare të moszhvillimit të shoqërisë sonë, pasi shkatërruan të gjitha vlerat, tani iu kanë vërsulur shkatërrimit të autonomisë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup! Me keqardhje, Instituti reagon ndaj informacioneve të publikuara të premten në media, në të cilat thuhet se drejtimi i këtij institucioni është pjesë e ndarjes së posteve qeveritare, dhe se gjoja posti i drejtorit do t'i takojë LR- PDSH-së. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, kërkon që të ndërpriten menjëherë këto akrobacione politike, dhe mos të jetë pjesë e pazarllëqeve të pista partiake - politike, pasi kjo bie në kundërshtim me Ligjin për veprimtari hulumtuese- shkencore dhe Statutin e ITSHKSH-së, si institucion shkencor - publik, që dhe si i tillë nuk e ka statusin e institucionit shtetëror - qeveritar. Me këtë rast, pyesim kryeministrin Zoran Zaev, kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti dhe kryetarin e LR-PDSH-së, Ziadin Sela, se vallë a e kanë shtruar në ndarjen e posteve politike edhe ASHAM-in, universitetet publike dhe institutet tjera hulumtuese- shkencore, dhe a është kjo në frymën e depolitizimit të institucioneve publike, siç pretendonin para formimit të qeverisë. Lidhur me tendencat për politizimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, do të njoftohen të gjitha misionet e huaja diplomatike në Maqedoni dhe organizatat joqeveritare", thuhet në fund të reagimit të ITSHKSH.

*Shkup, 4 gusht* - Një pjesë e marrëveshjes politike mes BDI-së dhe ASH-ët që u dakorduan një muaj më parë sa i përket ndarjes së eshalonit të tretë atë të drejtorive, të premten në media ka dalë lista e drejtorive që do i takojnë ASH. Ishte TV21 që publikoi këtë listën ndërsa e njëjta u konfirmua për gazetën KOHA edhe nga zyrtarë të lartë të LR-PDSH-së, por që deshën të mbeten anonim për publikun. Sa i përket ndarjes së drejtorive bie në sy edhe Instituti për Trashëgimi Kulturore të Shqiptarëve në Shkup që sipas marrëveshjes - do ti takojë LR-PDSH-së. Nga kjo parti e konfirmojnë këtë, por nuk japin detaje se si do të ndodhë kjo kur drejtori aktual ka mandat të rregullt pesëvjeçar. "Po, në listë e kemi edhe Institutin për Trashëgimi Kulturore, por se si do të rregullohet kjo punë, nuk i dimë ende detajet. Ato që kanë dalë në media në përgjithësi po, ato drejtori do ti takojnë Aleancës për Shqiptarët. Sa i përket emrave, ende nuk ka asgjë të re. Mbledhja e Kryesisë e paraparë të mbahet për të premten në ora 17 është shtyrë për shkak të mbledhjes së Qeverisë që filloi në ora 15. Pas mbledhje së Kryesisë, i mbetet Komisionit për çështje kadrovike të shqyrtojë kandidaturat nga degët e partisë", thonë për gazetën KOHA zyrtarë të lartë nga LR-PDSH. Në lidhje me këtë çështje, nëse vërtetet kanë marrëveshje me LR-PDSH që drejtori i ITKSH-së ti takojë kësaj partia, gazeta KOHA parashtroi pyetje deri tek zëdhënësi i BDI-së, Bujar Osmani, por deri në mbylljen e gazetës - nuk mori përgjigje. Ndërkohë, në opinion ka pasur zëra kritik menjëherë pas publikimit të këtij lajmi në drejtimin se, drejtori i ITKSH nuk është post politik, por ka mandat të rregullt pesëvjeçar me konkurs publik njëjtë siç ka edhe Akademia e Shkencave të Maqedonisë apo dhe Rektorët e Universiteteve. Ndryshe, TV 21 ka publikuar këto drejtori që do ti takojnë LR-PDSH-së edhe atë : FSPIM Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Burgu i Idrizovës, Entit Shtetëror për Statistikë, Këshillit Republikan për Siguri, Qendra "Jasen", Qendra klinike stomatologjike, Inspektorati Shtetëror i Tregut, ISHP i Nefrologjisë në Strugë, Klinika për sëmundje të syve, Avokati i Shtetit, Byroja për Ekspertiza Gjyqësore, Biblioteka e Qytetit të Shkupit (BKU Kliment Ohridski), Agjencia për Energjetikë, Byroja për Zhvillim të Arsimit, Qendra Shtetërore për Testim, Inspektorati shtetërorë për pylltari dhe gjueti, IP Qendra për punë sociale në Strugë, Instituti për Trashëgimi Shpirtërore të Shqiptarëve, si dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike. Ndryshe, po dje nga VMRO pati kritika ndaj partive në pushtet, pasi siç tha Ilija Dimovski, partisë me tre deputetë i jepen më shumë drejtori se sa duhet, duke aluduar kështu në LR-PDSH-në. Dimovski tha se "është absurde që një parti me vetëm tre deputet të marrë më shumë se 20 drejtori të rëndësishme dhe të kushtëzojë Qeverinë për Ligjin për gjuhët". Por këto akuza, deputeti nga LR-PDSH-së, Syrija Rashidi, i quajti qesharake. "Akuza qesharake. Ndarja e pushtetit është në proces normal i partneritetit mes partive të koalicionit qeveritar", theksoi Rashidi. Sa i përket Ligjit për gjuhën shqipe, Rashidi tha se aty nuk ka kompromis dhe se ai shumë shpejtë do të miratohet në Parlament. "Sa i përket Ligjit për gjuhën shqipe, aty nuk ka asnjë kompromis. Ligji po përgatitet aktualisht në Qeveri ku po shqyrtohen modalitetet e tij dhe presim që shumë shpejtë të vijë në seancë plenare. Ndërkaq, në lidhje me çështjen e Prokurorit Zvërlevski, deputeti i LR-PDSH-së tha se ai duhet një ditë e më parë të shkarkohet dhe të hapet rruga për reforma në gjyqësor. "Gjithsesi ne qëndrimin tonë për Marko Zvërlevskin e kemi thënë, duhet një ditë e më parë të shkarkohet, si një nga mundësitë kryesore për rrugën drejt një gjyqësie të pavarur. Jemi në gjendje të japim gjithçka që ajo të ndodhë një ditë e parë", është shprehur Rashidi. Ndryshe, Qeveria e Maqedonisë ka filluar me emërimet në institucione të ndryshme, borde mbikëqyrëse dhe ato drejtuese, por që nuk janë bërë publik ende emrat. Lidhur me këtë, zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, tha të premten se "emrat nuk mund të bëhen publik derisa Komisioni qeveritar për çështje kadrovike nuk e kontrollon dokumentacionin e tyre dhe nuk konfirmon se i përmbushin kushtet e nevojshme". Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Boshnjakovski informon se Qeveria në seancën e djeshme i miratoi të gjitha propozimet kadrovike dhe vendosi të emëroj anëtarë të Bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse në institucione, agjenci dhe organe tjera të cilat janë në kompetencë të saj. "Komisioni për çështje kadrovike i Qeverisë për secilin prej këtyre personave veçmas e kontrollon përmbajtjen e dokumentacionit të parashtruar që të konfirmojë nëse përmbushen kushtet për emërim. Në pajtim me faktet, kur kjo do të kontrollohet, vendimet do të dorëzohen deri te Gazeta Zyrtare", theksoi zëdhënësi. Sipas tij, emrat do të kumtohen në momentin e njëjtë kur kjo punë do të përfundohet, ndërsa pritet së shpejti.

# Edhe dy ditë deri në miratimin e rebalancit



*Shkup, 4 gusht* - Në ditën e tretë të debatit parlamentar për rebalancin e Buxhetit 2017, deputetët e VMRO-DPMNE-së e kritikuan Qeverinë e kryesuar nga LSDM për detyrime prej 110 milionë eurove për 70 ditë, edhe pse, theksuan ata, mu për detyrimet e kritikonin më së shumti pushtetin e kaluar derisa ishte në opozitë. Ministri Tevdovski nga foltorja e Parlamentit u bëri thirrje deputetëve nga opozita të mos prezantojnë të dhëna të pasakta për detyrimet dhe i sqaroi arsyet. Ai tha se në qershor dhe korrik neto detyrimi i ri në tregun vendor është bërë në shumë prej 1.8 miliardë denarëve apo 30 milionë euro dhe në periudhën e njëjtë është kthyer detyrimi ndaj kredisë së huaj në shumë prej 81.9 milionë euro. Lidhur me nevojën për detyrim, Tevdovski u përgjigj se në janar të vitit 2018 Maqedonia do të duhet vetëm për një kredi të huaj të kthejë 90 milionë euro të bërë nga pushteti paraprak. Në pjesën e pasdites të ditës së tretë të debatit për rebalancin e Buxhetit 2017, deputetët nga pushteti folën për borxhe të bëra në institucionet shtetërore nga pushteti i kaluar, shpenzimet joproduktive, për gabime në projektimin e autostradave… Deputetët opozitarë, ndërkaq replikuan për shkurtimin e investimeve kapitale dhe politikën me të cilën refuzohen investuesit e huaj. Akuzuan për ulje të mjeteve për mbështetje të zhvillimit rural, turizmit, universiteteve… përmendën edhe 500, sipas tyre punësime partiake, në MPB. Në diskutim pati edhe akuza për zjarret me vlerësimin nga deputetët opozitarë se Qeveria tashmë disa ditë është e pafuqishme të përballet me stihinë. Pjesa e pasdites e mbledhjes së sotme për rebalancin do të vazhdojë në orën 15:30, pas pauzës së rregullt.

# Apeli pranoi ankesën e Janevës, "bombat" mund të shfrytëzohen si dëshmi

*Shkup, 4 gusht* - Gjykata e Apelit Shkup e pranoi ankesën e Prokurorisë Speciale Publike me vendim të Gjykatës Themelore Shkupi 1 për lëndën lidhur me ngjarjet në Komunën Qendër në vitin 2013 dhe solli vendim se dëshmitë e marra nga materialet e përgjuara mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurë penale. "Gjykata e Apelit Shkup më datën 04.08.2017 solli vendim me të cilin e pranoi ankesën e Prokurorisë Speciale për ndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së kundërligjshme të komunikimeve Shkup dhe e shfuqizuan vendimin e sjellë nga Gjykata Themelore Shkupi 1 Shkup me të cilën nga regjistrimet e lëndës janë ndarë materiale e xhiruara të propozuara si dëshmi për lëndën lidhur me ngjarjet në Komunën Qendër. Me këtë vendim dëshmitë e marra nga materialet e përgjuara mund të përdoren si dëshmi në procedurë penale", theksohet në kumtesën e Gjykatës së Apelit Shkup.





# Kërkohet zgjidhje për problemin me KESH

*Shkup, 4 gusht* - Ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari paralajmëroi se është e mundur shpallje e tenderit për zgjedhjen e firmës e cila do të shtypë kartela të reja elektronike shëndetësore (KESH), për shkak se një numër i madh i qytetarëve, kartelat i kanë të pavlefshme, ndërsa një pjesë nuk i kanë marrë. Ai në takim me gazetarët informoi se sot do të ketë takim me drejtorët e Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë në të cilin do të bëhet fjalë për mënyrat për tejkalimin e problemit me KESH. "Deshëm ta zgjidhim këtë, ashtu që do të jetë tre në një, gjegjësisht letërnjoftimi, leja e qarkullimit dhe kartela shëndetësore në një. Por, nga MPB-ja më informuan se teknikisht është e mundur së bashku të jenë vetëm letërnjoftimi dhe kartela shëndetësore. Kështu që, do ta bëjmë këtë, por ky do të jetë një proces, i cili do të zgjasë në dy deri tre vitet e ardhshme. Deri atëherë do të duhet të shtypim kartela të reja", shtoi Taravari.



# Edhe 10 milionë euro ndihmë për bujqit

*Shkup, 4 gusht* - Në seancën e 19-të mbrëmë Qeveria dha pajtim për shpallje për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore për sipërfaqe deri në tre dhe mbi 3 hektarë. Në seancë janë sjell ndryshime të Propozim-programit për mbështetje financiare në bujqësi si dhe Programin për zhvillim rural me të cilët do të ndahen 10 milionë euro të reja mbështetje e drejtpërdrejtë për bujqit. Siç informon pres-shërbimi qeveritar, para ministrave ishte edhe informacioni për prodhimtari të pritur dhe blerje të grurit dhe elbit. Janë sjell konkludime me të cilat obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të përpunojë propozim program për ndryshim dhe plotësim të Programit për mbështetje financiare të bujqësisë në vitin 2017 dhe propozim Dekret për ndryshim dhe plotësim të Dekret për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2017. "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave mori për obligim nga Qeveria të përpunojë propozim për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për cilësi të prodhimeve bujqësore në pjesën e dispozitave, të cilat e rregullojnë tregun e miellit", kumtoi pres-shërbimi qeveritar.

## Ndryshimet klimatike po dëmtojnë prodhimtarinë

**Kursimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ujit, shfrytëzimi i mbetjeve të prodhimtarisë bujqësore për biodizel, përpunim i reduktuar i tokës, si dhe përdorimi i rrjeteve mbrojtëse janë vetëm disa nga masat për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që ju sugjerohen bujqve**



# Parashikime të zeza për bujqit

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 4 gusht* - Rendimente të përgjysmuara të pemëperimeve, kalbje e frutave të ndryshme, tharje e kokrrave frutoreve , thatësi e madhe apo mungesë e lagështisë pikërisht në kohën kur më së shumti ju nevojitet të mbjellave bujqësore, vështirësi që të dallohen mirë katër stinët vjetore... Këto janë vetëm disa nga brengat dhe hallet me të cilat ballafaqohen në vitet e fundit fermerët jo vetëm në Maqedoni dhe rajon, por edhe në tërë botën si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha klimatike. Ndryshimet klimatike tanimë janë realitet dhe një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet shoqëritë moderne. Ato shkaktojnë pasoja serioze ekologjike dhe sociale. Kjo duhet të merret parasysh sidomos në aspekt të asaj se në Maqedoni - më shumë se gjysma e popullatës është e varur ekonomikisht në mënyrë direkte apo indirekte nga prodhimtaria bujqësore dhe blegtorale. Vlerësimet tregojnë se temperaturat mesatare janë rritur me 0.2 - 0.5 për qind në vitet e fundit, shënohet rënie e sasive të të reshurave të shiut, rritet numri i ditëve të verës dhe netëve tropikale, si dhe evidentohet paraqitja e valëve të nxehtit. Trende të tilla pritet të vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme. Kursimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ujit, shfrytëzimi i mbetjeve të prodhimtarisë bujqësore për biodizel, përpunim i reduktuar i tokës, si dhe përdorimi i rrjeteve mbrojtëse janë vetëm disa nga masat për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që ju sugjerohen bujqve. Nga ana tjetër, hulumtimet të realizuara në Maqedoni tregojnë se në rajon, definitivisht ndryshimet klimatike në mënyrë serioze do të limitojnë rendimentet si rrjedhojë kryesisht e mungesës së ujit.

"Ndryshimet klimatike bile edhe në afat të shkurtër deri në vitin 2030, në Maqedoni do të fillojnë të tregojnë efekte negative, gjegjësisht ulje të rendimenteve. Për fat të mirë, bujqit tani kanë filluar të ndërmarrin masa adaptuese për tu bërë ballë ndryshimeve të tilla përmes vaditjes së tokave punuese. Nëse realizohen ndryshime serioze në sektorë të ndryshëm për zgjerimin e hapësirave që do të vaditen, ndryshimet klimatike në suaza afatshkurtra nuk do të kenë pasoja serioze për bujqësinë në Maqedoni", thotë profesori i bujqësisë, Ordan Çukaliev.

Sipas tij, po përgatiten edhe masa tjera për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike siç janë mbrojtja e kulturave sidomos në vreshtari dhe pemëtari përmes rrjeteve mbrojtëse, teknikat për ruajtjen e truallit etj. Agronomët vlerësojnë se adaptimi i prodhimtarisë bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike në radhë të parë nevojitet të orientohet ndaj rehabilitimit të sistemeve për vaditje që vitet e fundit - në Maqedoni, si proces po shkon ngadalë, dhe shfrytëzimin sa më efikas të ujit në bujqësi. Sugjerohet edhe konzervimi i tokës dhe ujit për të parandaluar erozionin e tokës, si dhe parandalimin e tepricës së kripërave në truall si rrjedhojë e vaditjes së tepërt. Kërkohet edhe një seleksionim më i kujdesshëm i sortave që do të jenë më toleruese ndaj thatësisë dhe stresit që shkakton vapa. Me tej, trendet demografike në Maqedoni si plakja e popullsisë, si dhe orientimi i vogël i të rinjve që të merren me bujqësi - pakëson edhe kapacitetin adaptues të vendit ndaj ndryshimeve klimatike. Në ndërkohë, agronomët kërkojnë edhe kujdes gjatë renditjes së kulturave të ndryshme, përzgjedhjen e kulturave rezistente ndaj keqbërësit dhe luhatjet e mëdha të temperaturave të temperaturave ekstreme. "Në favor të mbrojtjes së bujqësisë dhe blegtorisë nga ndryshimet klimatike, do të ishte edhe shfrytëzimi sa më racional i ujit për vaditje si grumbullimi i ujit të shiut apo shfrytëzimi i sistemit pikë për pikë, ulja e shfrytëzimit të tepërt të kullosës nga kafshët për shkak të mbrojtjes nga vërshimet dhe erozioni, rritja e hapësirave nën pyje dhe kufijtë e gjelbërimit në rajonet bujqësore, kujdes më i madh për shëndetin e kafshëve, përpunimi i drejtë i tokës, ulja e lëshimit të azotit përmes shfrytëzimit efikas të plehrave...", thotë eksperti i bujqësisë, Blagojçe Naumovski

Sipas tij, duhet të shqyrtohen edhe masat e mënyrës së trajtimit të ugareve për shkak të ruajtjes së lagështisë dhe materieve organike, zvogëlimit të numrit të racave vendore dhe vendosjen e racave që janë më rezistente ndaj thatësirës, rritjen e kulturave që rriten shpejt për të dhënë sa më shumë rendiment, lëshimin e rritjes së monokulturave etj. Ndryshe, analizat e Bankës Botërore tregojnë se Maqedonia në 40 vitet e ardhshme në mesatare do të rriten temperaturat për 1.8 gradë në raport me rritjen prej 0.2 gradë celsius e matur në 50 vitet e kaluara. Të reshurat do të jenë më të ndryshueshme, ose ulje për tetë milimetra në muaj respektiv deri në vitin 2040. Megjithatë, mesatarja vjetore është më pak e rëndësishme për prodhimtarinë bujqësore sesa distribuimi sezonal i temperaturave dhe të reshurave. Rritja e temperaturave projektohet të jenë më të larta, ndërsa ulja e të reshurave të jetë më e madhe në periudhën kritike të verës, ose gjatë rritjes së kulturave bujqësore. Rritja e temperaturave verore në mesin e shekullit bile mund të jetë edhe për 4-5 gradë në zonën kontinentale të Maqedonisë thekson analiza e Bankës Botërore.

## BANKA BOTËRORE JEP ALARMIN

Ndryshe, analizat e Bankës Botërore tregojnë se Maqedonia në 40 vitet e ardhshme në mesatare do të rriten temperaturat për 1.8 gradë në raport me rritjen prej 0.2 gradë celsius e matur në 50 vitet e kaluara. Të reshurat do të jenë më të ndryshueshme, ose ulje për tetë milimetra në muaj respektiv deri në vitin 2040. Megjithatë, mesatarja vjetore është më pak e rëndësishme për prodhimtarinë bujqësore sesa distribuimi sezonal i temperaturave dhe të reshurave. Rritja e temperaturave projektohet të jenë më të larta, ndërsa ulja e të reshurave të jetë më e madhe në periudhën kritike të verës, ose gjatë rritjes së kulturave bujqësore. Rritja e temperaturave verore në mesin e shekullit bile mund të jetë edhe për 4-5 gradë në zonën kontinentale të Maqedonisë thekson analiza e Bankës Botërore.

# Eksporti rritet për 16.2 për qind, importi për 11.2

*Shkup, 4 gusht* - Vlera e përgjithshme e eksportit të mallrave nga Republika e Maqedonisë, në periudhën janar-qershor të vitit 2017, është 146.245.456.000 denarë dhe shënon rritje prej 16.2 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Vlera e mallit të importuar, madhe, është 199.947.002.000 denarë që është rritje për 11.2% në krahasim me gjysmëvjetorin e parë të vitit të kaluar, njofton Enti Shtetëror për Statistikë. Deficiti tregtar, në periudhën janar-qershor të vitit 2017, është 53.701.246.000, ndërsa mbulimi i importit me eksport është 73.1%. Këmbimi tregtar sipas prodhimeve tregon se në eksport më e madhe është pjesëmarrja e katalizatorëve të bartësve me metale fisnike ose komponime të tyre, sete të përçuesve për djegie dhe ngjashëm, për automjete, aeroplanë ose anije, ferronikeli dhe veshjet. Në import më së shumti janë të përfaqësuara platini dhe legurat e platinit, të papërpunuara ose në pluhur, vajra të naftës dhe vajra të fituara nga mineralet bituminoze (përveç i papërpunuar), metalet e tjera nga grupi i platinit dhe legurat e tyre, të papërpunuara ose në formë të pluhurit dhe energjia elektrike. Në periudhën janar-qershor 2017, sipas vëllimit të përgjithshëm të këmbimit të jashtëm tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë.



Duke i komentuar zjarret që e kanë përfshirë rajonin e Shkupit, drejtori i Ndërmarrjes Publike "Parqe dhe Gjelbërime", Dushan Aviroviq, ka thënë se 100 për qind e këtyre zjarreve janë shkaktuar nga faktori njeri



Pyjet vazhdojnë të digjen, shkaqet pritet të hetohen

# Shkupi dhe rrethina në luftë me zjarret

**Temperaturat e larta dhe mungesa e lagështisë, sipas organeve përkatëse, paraqet njërën prej arsyeve se pse po shkaktohen zjarret, megjithatë drejtori i QMK-së, Shaban Saliu, në disa raste ka theksuar se disa prej zjarreve që janë paraqitur se fundmi janë shkaktuar nga faktori njëri**

Koha Omer XHAFERI



*Shkup, 4 korrik* - Përkundër përpjekjeve për të lokalizuar zjarret që disa ditë me radhë i kanë kapluar pyjet e ndryshme të Maqedonisë, sipas Qendrës për Menaxhim me Kriza (QMK), edhe më tej një pjesë e këtyre zjarreve mbeten aktiv, madje me shpejtësi po zgjerohen. Qindra hektarët e djegur, kryesisht hapësirë malor në pronë të shtetit - ka ndikuar që Qeveria brenda orëve të para 4 korrikut të sjellë vendim me të cilin pritet të hetohen shkaqet që i kanë shkaktuar zjarret, të cilat për ditë të tëra kanë bërë kërdi në më shumë lokacione brenda Maqedonisë. Temperaturat e larta dhe mungesa e lagështisë, sipas organeve përkatëse, paraqet njërën prej arsyeve se pse shkaktohen zjarret, megjithatë drejtori i QMK-së, Shaban Saliu, në disa raste ka theksuar se disa prej zjarreve që janë paraqitur se fundmi, janë shkaktuar nga faktori njeri. Në këtë drejtim, policia e shtetit ende nuk ka njoftuar se si zhvillohen hetimet në këtë drejtim, gjegjësisht nëse është arrestuar apo marrë në pyetje ndonjë i dyshuar. Nga ana tjetër, ekipet e zjarrfikësve të rajonit të Shkupit me intervenimin e fundit që e kanë kryer në orët e para të ditës së premte - kanë bërë të ditur se zjarri në malin e Matkës është lokalizuar. Ndërkohë, siç mëson gazeta KOHA, pjesa e malit të Zhedenit që gjendet në afërsi të fshatit Bojanë, ende është aktiv. Banorët e këtij fshati përmes Bashkësisë Lokale, kanë thënë se menjëherë pas vërtetimit të lajmit se mali Zheden është kapluar nga flakët, ata e kanë paraqitur rastin te shërbimet e zjarrfikësve të cilët me vonesë të madhe janë paraqitur në vendngjarje. Në anën tjetër të rrethinës së Shkupit, në fshatin Moranë, pjesë e Komunës së Studeniçanit, ekipet e zjarrfikësve kanë theksuar se gjatë orëve të para të ditës, kanë intervenuar në shuarjen e zjarrit që e ka përfshirë fushën e kësaj ane edhe atë me dy automjete për shuarje të zjarreve dhe gjashtë zjarrfikës. Duke i komentuar zjarret që e kanë përfshirë rajonin e Shkupit, drejtori i Ndërmarrjes Publike "Parqe dhe Gjelbërime", Dushan Aviroviq, ka thënë se 100 për qind e këtyre zjarreve janë shkaktuar nga faktori njeri. "Të ishte terreni më i përshtatshëm, zjarri në rrethinën e Matkës do të ishte lokalizuar menjëherë. Por, ajo që ndodhi gjatë 24 orëve të fundit ishte e tmerrshme. Sinqerisht, i bindur jam se këto zjarre në rrethinën e Shkupit janë me tendencë të shkaktuar. Për këtë situatë nuk ekziston ndonjë sqarim tjetër se këto zjarri mund të shkaktohen ndryshe, gjegjësisht argumentet se mali është vetëndezur - nuk qëndrojnë. Thjeshtë, vlerësoj se bëhet fjalë për mungesë të kulturës dhe vetëdijes qytetare, ose thënë ndryshe - sëmundjes të cilën e kanë njerëz të caktuar", ka thënë drejtori Aviroviq. Ndryshe, zjarr tjetër i regjistruar në kryeqendër gjatë orëve të para të mëngjesit të ditës së premte, është parë mbi fshatin Çiflik, rrethinë e Komunës së Sopishtes, e cila 90 për qind është banuar me shqiptarë. Për këtë rast, drejtori Dushan Aviroviq, ka theksuar se me ndihmën e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilët kanë intervenuar në këtë rajon me helikopter - zjarri është lokalizuar dhe vënë nën kontroll. Flakëve të zjarreve, sipas drejtorit Aviroviq, gjatë periudhës së fundit nuk i kanë shpëtuar edhe dy malet me të frekuentuara në kryeqytet, gjegjësisht mali Vodno dhe ai i Gazi Babës, kur relativisht ka pasur zjarre të vogla, të cilët për shkurtë kohë janë shuar.

### Zjarri në Makedonski Brod ende aktiv, vullnetarë ende drejtohen për shuarje

Zjarri në zonën e fshatrave Trebovlje dhe Rastesh në Makedonski Brod ende është aktiv. Në shuarjen janë angazhuar ARM-ja, tre helikopterë (nga një nga ARM-ja, nga Bullgaria dhe nga Turqia) të cilët veprojnë nga orët e mëngjesit, banorët e vendit nga fshati Rastesh dhe persona nga fshati Zagrad, ndërsa drejtohen edhe vullnetarë nga Kërçova, Prilepi dhe Shkupi. Siç kumtoi Qendra për menaxhim me kriza, forcat e Ekonomisë pyjore "Sandanski" nga Makedonski Brod janë angazhuar për veprimin e zjarrit në fshatin Rastesh. Ata ndërmarrin aktivitete për lokalizimin e zjarrit që të mos afrohet deri te shtëpitë dhe stallat me kafshë të cilët janë në rrezikëm bëzën e fshatit Rastesh, si dhe pengimi i zjarrit në vendin e quajtur Koritski Doll që të mos zgjerohet drejt fshatrave Rastesh dhe Zagrad. Në zjarrin në fshatin Deviç janë angazhuar persona nga Ekonomia pyjore "Sandanski" - Makedonski Brod. Zjarrin po kontrollohet dhe shtëpitë që janë lartë fshatit Deviç nuk janë në rrezik, por ende është aktiv me intensitet të zvogëluar te vendi i quajtur Polec. Në zjarrin në fshatin Blizansko ka intervenuar edhe një helikopter dhe tani për tani nuk ka vatra të mëdha. QMK informon se ende është aktiv zjarri në Podvis - Lokveni, i cili është zgjeruar në pjesën e kodrës drejt fshatrave Aldanci dhe Norovë. Digjet kashtë dhe pyll me drunj të shkurtër, ndërsa në terren për momentin intervenojnë ekipe të NJTZ Krushevë dhe NP "Lipa"- Krushevë. Në rajonin e Tetovës aktive janë dy zjarre në ambient të hapur. Mbi fshatin Kopance ku digjet sipërfaqja me bari të thatë nëpër malin Zheden nuk është përfshirë pylli. Në vendin e ngjarjes është ekipi i Ekonomisë pyjore "Leshnicë" - Tetovë. Në zonën e fshatit Gurgurnicë aktiv është zjarri që nga ana e Makekdonski Brodit është përhapur në territorin e komunës Bërvenicë. Digjet bari i thatë dhe kullosë, ndërsa ekipi nga Ekonomia pyjore "Leshnica" - Tetovë është në terren dhe e ndjek situatën. Zjarri në fshatin Zhelezna Reka është lokalizuar mbrëmë në orën 23:00.

### Qeveria falënderon Turqinë dhe Bullgarinë për ndihmë

Në seancën që u mbajt të enjten mbrëma në Qeveri ka marrë pjesë edhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Shaban Saliu, i cili i ka informuar ministrat për gjendjen me zjarret në rajonin e Makedonski Brodit dhe në disa lokacione nëpër vend. "Në këtë kontekst, Qeveria e Republikës së Maqedonisë shprehu falënderim të madhe deri te Republika e Bullgarisë, si dhe deri te Republika e Turqisë për ndihmën e dërguar në ballafaqimin me zjarret. Është theksuar se institucionet janë në terren deri në shuarjen përfundimtare dhe lokalizimin e zjarreve, ndërsa janë ndërmarrë edhe obligime që të hetohen arsyet për paraqitjen e shpeshtë të zjarreve në disa lokacione nëpër vend", njoftojnë nga Qeveria.

## I GJITHË BALLKANI PËRFSHIHET NGA FLAKËT

Më shumë se njëqind zjarrfikës edhe më tej po luftojnë me stuhitë e zjarri në rajonin e Ballkanit. Në Kroaci zjarret në rajonin e Kistanjes, të cilët filluan të martën ende nuk janë lokalizuar, e as shuar. Atje në terren momentalisht ndodhen 300 zjarrfikës nga e gjithë Kroacia me 37 automjete, si dhe 50 pjesëtarë të ushtrisë, të cilët shuajnë tre zjarre. Hina njofton se stuhia e zjarrit ka përfshirë dy mijë hektarë tokë, ndërsa në shuarje përkohësisht marrin pjesë edhe aeroplanë "kanaderrë". Në Parkun nacional "Kërka" më askund nuk shihet zjarr i hapur, deklaroi drejtori i këtij institucioni publik Kreshimir Shakiq. Ai shtoi se zjarri, i cili nga e marta është aktiv në këtë rajon ka përfshirë rreth 200 hektarë sipërfaqe nga Parku nacional. Në rajonin e qytetit boshnjak Trebinje zjarrfikësit po mbajnë kujdestari dhe po e kontrollojnë zjarrin rreth fshatit Slivnicë, ndërsa në Hercegovinë kishte disa zjarre më të vogla, të cilët me sukses janë shuar. Zëdhënësi i Mbrojtjes civile të Republikës Srpska, Zhelko Stojanoviq deklaroi se është shkaktuar zjarr në një deponi për mbeturina në Bratunac dhe shtoi se ai kërkon shuarje më të gjatë dhe aksione komunale. Zjarret janë aktive edhe në malin Dinara mbi lagjet Çaprazle dhe Donji Rujani dhe në rajonin e komunës Bosansko Grahovo në malin Staretina në kufirin me komunën Gllamoç, të cilët për shkak të terrenit jashtëzakonisht të pakalueshëm dhe të minuar, është e mundur të shuhen vetëm nga ajri, njofton FENA. Dje pasdite një zjarr shpërtheu edhe në ishullin grek Lezbos, të cilin zjarrfikësit vështirë e shuan për shkak të erës së fuqishme, njofton ANA-MPA.

## Në fundjavë mot shumë i ngrohtë, deri në 42 gradë

*Shkup, 4 gusht* - Deri të enjten rajoni i Maqedonisë do të jetë nën ndikim të masës ajrore stabile dhe shumë të ngrohtë, që do të kushtëzojë të vazhdojë periudha e motit kryesisht me diell, shumë të ngrohtë dhe të thatë. Në pjesën më të madhe të vendit temperatura maksimale do të arrijë mbi 35, ndërsa në disa vende përgjatë Vardarit do të tejkalojë 40 gradë, njofton DPHM-ja. Më ngrohtë pritet të jetë gjatë fundjavës, kur temperatura maksimale në vend do të arrijë edhe 42 gradë. Nga e hëna në orët e pasdites do të ketë paraqitje të vranësirave mesatare lokale. Indeksi UV edhe më tej do të jetë shumë i lartë me vlerë 9. Sipas temperaturave të parashikuara gjatë ditëve të ardhshme, disa rajone të vendit do të jenë në fazën portokalli lidhur me rrezikun nga temperaturat e larta.

## Më 7, 8 dhe 9 gusht udhëtarët në aeroportin e Shkupit të vijnë katër orë më herët

*Shkup, 4 gusht* - Të gjithë udhëtarët të cilët kanë fluturime nga aeroporti i Shkupit "Aleksandri i Madh" më datën 7, 8 dhe 9 gusht, duhet të arrijë në aeroport tre deri në katër orë më herët se koha e nisjes. Siç informojnë nga TAV Maqedoni, kjo është për shkak të masave shtesë të sigurisë, të cilat do të zbatohet në aeroport me rastin e mbajtjes së ndeshjes së UEFA Super Kupës.

## Mund të hiqet udhëzimi me prioritet



*Shkup, 4 gusht* - Heqja e udhëzimit me prioritet dhe vendosja e udhëzimit urgjent është opsioni të cilin e paralajmëroi ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari në takimin me gazetarët. Sipas tij, një numër i madh i udhëzimeve me prioritet po keqpërdoren. Udhëzimi urgjent do të mund të jepet vetëm për diagnoza fikse, siç janë për shembull goditja në tru, tumor në tru, komplikime më serioze... Duke u përgjeruar në Sistemin nacional për evidenca elektronike në shëndeti "Termini im", Taravari informoi se i kanë marrë propozimet nga të gjitha klinikat për kohëzgjatjen e kontrollit.

Në periudhën në vijim atje ku duhet do të rritet kohëzgjatja e kontrollit. Në lidhje me mbajtjen e higjienës në klinikat e Shkupit dhe sallat e kirurgjisë, tha se po shqyrtohet mundësia për angazhimin e formave të jashtme për pastrimin e tyre. "Një pjesë të mjeteve do t'i mbulojë Ministria e Shëndetësisë, ndërsa një pjesë vetë klinikat.

Nëse kjo do të jetë e suksesshme në tre-katër muajt e ardhshëm, atëherë do të vendosim, si kriter, FSSHM-ja buxhetin që ua jep klinikave për higjienë ta drejtojë që edhe pastrueset të punësohen në ato firma, që është kusht nëse dëshirojnë të arrijnë marrëveshje me Ministrinë. Përgjegjësia për tërë higjienën në klinika të jetë e atyre firmave", sqaroi ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari.

Republika e Maqedonisë
**Qeveria e Republikës së Maqedonisë**
Sekretariati për Çështje Evropiane

**SHPALLJE PËR PUNËSIM NË SEKRETARIATIN PËR ÇËSHTJE EVROPIANE**

**Në bazë të nenit 22 paragrafi 8 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 21/14, 199/14 dhe 27/16), në përputhje me nenin 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (''Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë'' nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 и 27/16) Sekretariati për Çështje Evropiane, shpall**

**SHPALLJE PUBLIKE**

për punësim të 1 (një) këshilltari të posaçëm në Kabinetin e Zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, për kohë të caktuar

1. Këshilltar i posaçëm për përkrahje në procesin e integrimit (1) zbatues
   Kandidati duhet ti plotësojnë këto: kushte të përgjithshme (për të gjithë kandidatët):
   - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
   - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
   - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos kenë ndalesë për kryerje profesioni, veprimi ose detyre.

Kandidati për pozitën me numër 1, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të kenë:
- Përvojë pune prej së paku 5 vitesh, ndërkaq përparësi do të kenë kandidatët që kanë përvojë në media të huaja;
- Njohje në një ose më shumë prej fushave në vijim: integrime evropiane, marrëdhënie me publikun; bashkëpunim rajonal, sektori civil .

Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim. Kandidatët me fletëparaqitjen duhet ti dorëzojnë dëshmitë për plotësimin e kushteve, në formë origjinale ose kopje të verifikuar në notar:
1. Dëshmi për nënshtetësi të Republikës së Maqedonisë,
2. Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
3. Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk ka ndalesë për kryerje profesioni, veprimi ose detyre,
4. Vërtetim / diplomë për shkallën e arsimit të kryer,
5. Dëshmi për përvojë pune, (për kandidatët për pozitën me numër 1)
6. Biografi të shkurtër

Orari i punës: Orë pune në javë: 40, orari i punës nga 08:30 deri 16:30, ditë pune: prej ditës së hënë deri ditën e premte. Shuma e parave e rrogës bazë bruto është 54.989 denarë (shuma në bazë neto është 36.864 denarë).

Me kandidatin e përzgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të caktuar.

Punësimi i këshilltarit zgjat deri në përfundimin e mandatit të Zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë, duke u llogaritur një ditë pas publikimit të shpalljes (duke mos e llogaritur ditën e publikimit të shpalljes).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet ti plotësojnë në momentin e paraqitjes. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 10 ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitje, varësisht nga numri i kandidatëve të paraqitur.

Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në arkivin e Sekretariatit për Çështje Evropiane "Kej Dimitar Vllahov, nr. 4" 1000 Shkup, me shënim "Për shpalljen për Këshilltar të posaçëm". Fletëparaqitjet e dorëzuara nëpërmjet postës, duhet të pranohen në arkivin e Sekretariatit për Çështje Evropiane më së voni deri në ditën e përfundimit të afatit të shpalljes publike. Fletëparaqitjet e vonuara dhe të pa kompletuara nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për paraqitje është: 10.08. 2017.
Me respekt,
**Dr. Bujar Osmani**

Zëvendëskryeministër i Qeverisë
Përgjegjës për Çështje Evropiane
Përgatiti: Vladimir Pallashevski
Kontrolloi: Maja Fuzevska Veljanovska
Miratoi: Biljana Butlevska

---

Republika e Maqedonisë
**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**

МКД СЕРТИФИКАТ
МКС EN ISO 9001:2009

. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,

**SH P A LL J E**
Projekt A – Leje e integruar ekologjike
për Arcelor Mittal (CRM) SH A - Shkup,
Rr.Brigada e 16[të] Maqedonase nr. 18
1000 Shkup

Instalacioni Arcelor Mittal (CRM) SH A - Shkup, dorëzoi Kërkesë deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për marrjen e A-lejes për harmonizim me planin operativ. Pasi zbatimit të procedurës ligjore, MMJPH dorëzoi Leje për harmonizim nr. 11-7295/4 nga 30.06.2014.
Si rrjedhojë, pas realizimit të inspektimit më 16.02..2017 v. dhe shqyrtimin e gjendjes faktike si dhe njoftimin e pranuar për realizimin e plotësishëm të planit operativ ( Në përputhje me nenin 138 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit mjedisin jetësor ( Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13 , 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16**),** Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e zbaton procedurën e më tejme për marrjen e A – lejes së integruar ekologjike
Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve, bien nën aktivitetet nga Shtojca I, Pika:

- 2.3 Instalacione për përpunimin e ferometaleve:

a). Petëzim me kapacitet mbi 20 t/ orë çelik i pa përpunuar ; Fonderi për për ferometale me kapacitet prodhues mbi 20 t/ ditë ;
v). Vendosjen e shtresës mbrojtëse nga metali i shkrirë, me hyrje më madhe se 2 t/orë çelik i pa përpunuar .

Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë MMJPH përgatiti
Projekt A – Lejes të integruar ekologjike
për Arcelor Mittal (CRM) SH A - Shkup,
Rr.Brigada e 16[të] Maqedonase nr. 18
1000 Shkup

Projekt Leja do jetë e shpallur , në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk
Informacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: . 070 243 398 ( e-mail: s.gligorova@moepp.gov.mk )
Të interesuarit, në **afat prej 14 ditëve** nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet ti dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi " Goce Delçev" nr. 18 ( ndërtesa e MTV kati 10 ), 1000 Shkup.

---

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16") dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15"), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16") dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15"), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 32/2017

për punësimin e 1 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Zhelinës "për vendet e punës në vijim:

1. Dëshmi për shtetësi të Republikës së Maqedonisë;
2. Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
3. Dëshmi se me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
4. Certifikatë/diplomë për kryerjen e shkallës së arsimit në pajtim me kushte e shpalljes;
5. Dëshmi për përvojë pune;
6. Dëshmi për kryerje të punëve të nivelit të udhëheqjes;
7. Dëshmi për njohjen e gjuhëve të huaja në pajtim me kushte e shpalljes

**Orari i kohës së punës: orë punë në javë: 40, orari i punës prej orës** 08:30 deri në orën 16:30, ditë e punës: prej të hënën deri të premten.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet kontratë për punësim në kohë të pacaktuar.

Afati i dorëzimit të fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune, duke llogaritur nga dita vijuese e ditës së shpalljes së konkursit (duke mos e llogaritur ditën e shpalljes).

Kushtet e theksuara në konkurs, kandidati duhet ti plotëson në momentin e paraqitjes.

Në qoftë se në konkursin publik paraqiten deri më 200 kandidatë, zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditësh, prej 201 deri më 500 kandidatë, zgjedhja do të realizohet në afat prej 90 ditësh dhe mbi 500 kandidatë, zgjedhja do të realizohet në afat prej 120, pas skadimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në hapësirat e Ndërmarrjes publike për menaxhim me objektet sportive dhe afariste "Shkupi i vjetër" – Shkup, rr. H.T.Karposh nr. 5, Shkup, me shenjë "për konkursin për punësim në Ndërmarrjen publike për menaxhim me objektet sportive dhe afariste "Shkupi i vjetër" – Shkup"

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe jo në kohë nuk do të shqyrtohen.

**Afati përfundimtar për paraqitje: 11.08.2017.**

Personi për kontakt: Muhamed Alimi, kontakt: 071 223022

Me respekt,

**U. D. Drejtor i Ndërmarrjes publike për menaxhim me**
**menaxhim me objektet sportive dhe afariste "Shkupi i vjetër" – Shkup**
**Muhamed Alimi**



Veton SURROI

# Njeriu ynë në Afganistan

**Shqiptarët në shoqëritë e tyre janë cak i veçantë për islamikët. Arsyeja madhore për këtë është vlera jonë kombëtare, është veçoria e shqiptarëve që nuk e ka të spikatur në këtë mënyrë asnjë popull tjetër evropian: kapacitetin e integrimit të lirë të besimeve të ndryshme fetare brenda qenies sonë kombëtare**

**1.** Qe ftesë jo e zakonshme për të promovuar një libër: një kolonel i forcave speciale që kishte luftuar në Afganistan dhe Irak më ftonte për të folur për analizën e tij të gjatë për ngritjen dhe rënien e ISIS-it. Zhvillimi, në dukje, i jashtëzakonshëm nuk përfundon këtu - pra, që të lexoj dhe vlerësoj librin e një koloneli të forcave speciale. Më të jashtëzakonshme, në dukje, e bën faktin se Koloneli është i Ushtrisë së Shqipërisë, ndërsa promovimi bëhet në Tiranë.

Por, ajo që për publikun shqiptar do të duhej të dukej e jashtëzakonshme - të flasësh për ISIS-in në Tiranë nga aspekti i operacioneve strategjike e taktike të sigurisë-është vetëm rrjedhë logjike e një pozicionimi historik të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Shqipëria është shtet anëtar i NATO-s që nga viti 2008 dhe u ftua që menjëherë të futet në ujërat e misioneve "out of area" (jashtë territorit të shteteve anëtare), fillimisht në Afganistan e pastaj dhe kudo të jetë nevoja. Në këto misione, njeriu ynë në Afganistan, e pastaj në Irak, në krye të njësiteve speciale ishte koloneli Dritan Demiraj, autori i librit "Ngritja dhe rënia e Shtetit Islamik – ISIS". Njëra formë e leximit të këtij libri mund të jetë si pjesë e përcaktimit të doktrinës shqiptare të mbrojtjes. Njësitet shqiptare që morën pjesë në Afganistan e Irak, dhe kudo të ketë nevojë në misionet e NATO-s janë zbatim e "smart defence" (mbrojtje e mençur), një koncepti të adoptuar strategjik të NATO-s, ku çdo shtet anëtar kontribuon me aftësitë e veta më të mira. Nëse Estonia ka formacionet më të mira për luftë kibernetike, ndërsa Danimarka specializohet në operacione detare apo aviacion, Shqipëria nuk do të sillte ndonjë risi po që se duplifikonte këto kapacitete. Por, njësitet shqiptare janë treguar më së miri, për një kohë shumë të shkurtër përgatitjeje, që të jenë pjesë e njësiteve elitare të specializuara, si për luftim në pararojë ashtu edhe për trajnim të forcave, madje edhe atyre aleate. Dhe ardhmëria fare lehtë mund t'i gjejë forcat shqiptare (përfshirë këtu edhe Kosovën që ka aspiratën e NATO-s) që të zhvillojë doktrinën për konvergjencë brenda NATO-s, njësite të lëvizshmërisë së lartë që janë të gatshme të dislokohen në operacione jashtë apo brenda kufijve të shteteve anëtare. Të zhvillojnë pra një doktrinë në bazë të rezultateve tashmë të dëshmuara nga njësitet e komanduara nga koloneli Demiraj.

**2.** Në tokën dhe kohën ku rrojmë biseda rreth një libri për ISIS-in shkruar nga një kolonel i forcave speciale nuk ka të bëjë aq shumë me ekzotikë sa ka të bëjë me sfida realiteti. I tërë kontinenti evropian ka ndier prej kohësh problemet e Lindjes së Mesme, dhe në mënyrë dramatike me krizën e refugjatëve sirianë, por me zhbërjen e shteteve të Irakut dhe të Sirisë - që janë procese të shkaktuara nga vendimet e gabuara politike për ndërhyrje në Irak e pastaj mosndërhyrje në Siri-pasojat po trokasin edhe në shtëpitë shqiptare. Është i madh, përpjestimisht dhe jopërpjestimisht, numri i shqiptarëve që luftojnë në radhët e ISIS-it dhe është i madh, përpjestimisht e jopërpjestimisht, numri i atyre shqiptarëve që kanë filluar ta shndërrojnë besimin e tyre fetar në besim ideologjik. Dhe libri i kolonel Demirajt shpjegon në të njëjtën kohë se si mund të mposhtet ushtarakisht ISIS, por po ashtu se si organizatat ushtarake e terroriste islamike ringjallen me emër tjetër, siç është rasti me Al Qaedan, që në Siri u rizbulua si Al-Nusra. Sfida, rrjedhimisht, është se si pas mposhtjes ushtarake të ISIS-it të mos lindë një ISIS tjetër.

**3.** Këtu më pak mund të ndihmojë ushtria e më shumë politika. Islamikët e sotëm të ISIS-it janë, siç shpjegohet edhe në libër, strukturim ushtarak i oficerëve të Sadam Husseinit. Shkurt, janë përgjigja islamike ndaj pushtimit amerikan në momentin kur dështoi përgjigjja shtetërore-sekulare. Konceptualisht, ISIS-i është forma më ekstreme e një procesi që kishte filluar prej shumë kohësh, e ai është islamizimi i kauzave. Pas vitit 1967, kur Izraeli fitoi luftën gjashtëditëshe kundër aleancës së shteteve arabe, nacionalizmi shekullar arab u sfidua nga lëvizja islamike. Vëllazëria myslimane në Egjipt u bë bartëse e opozitës ndaj dështimeve shtetërore dhe u bë simbol se si islamizohet një kauzë joreligjioze. Kjo u pa në formë më plastike në lëvizjen palestineze, e cila u islamizua në masë të madhe me Hamasin. Dhe përderisa çështjet e ndryshme të pazgjidhura arabe të vazhdojnë, do të vazhdojë edhe presioni për islamizimin e kauzave arabe.

Hapësira për islamizimin e kauzave (d.m.th, politizimin islamik të tyre) është jashtëzakonisht e madhe: mbulon shtetet jofunksionale si Iraku e Siria, lëvizjet për shtetndërtim si Palestina e deri te kauzat kombëtare, siç është rasti i shqiptarëve të Maqedonisë ku lëvizjeve politike shqiptare u konkurrojnë ato që kanë emërtuesin fetar para atij kombëtar.

**4.** Në fakt, shqiptarët në shoqëritë e tyre janë cak i veçantë për islamikët. Njëra prej arsyeve, natyrisht, është lehtësia me të cilën treguam se mund të integrohemi në NATO dhe të veprojmë në misionet e saj. Përcaktimi Atlantist është krejtësisht i kundërt me perceptimin islamik për shqiptarët. Arsyeja tjetër është se në ADN-në e lëvizjeve islamike tashmë ekziston një nuhatje e veçantë për veprim tek shtetet e dobëta. Sa më të dobëta institucionet e shtetit, apo sa më të korruptuara elitat politike (si në rastin e Kosovës) aq më e madhe hapësira për veprim të ideologjisë së islamit politik, gjë që u pa në mjediset prej nga u rekrutuan luftëtarët shqiptarë të ISIS-it. Por arsyeja madhore për veprim të islamikëve është vlera jonë kombëtare, është veçoria e shqiptarëve që nuk e ka të spikatur në këtë mënyrë asnjë popull tjetër evropian: kapacitetin e integrimit të lirë të besimeve të ndryshme fetare brenda qenies sonë kombëtare.

Të këtillë, shqiptarëve i pengon cilido keqpërdorues i religjionit, cilido të jetë ai. *(koha.net)*



Armand SHKULLAKU

# A është popull Edi Rama

**Strategjia e kryeministrit për të shuar etjen e qytetarëve për më shumë mirëqenie duke u hedhur kokat e prera të disa burokratëve dhe për t'i përdorur këto si koka turku për të mbuluar mëkatet e veta, është e qartë**

Sikur të mos iu mjaftonte i nxehti përvëlues i kësaj stine, shqiptarëve u duhet të durojnë edhe një stinë të shpifur politike, të cilën mendonin se e kishin kapërcyer një çerek shekulli më parë. Këto ditë, ata po shqyejnë sytë duke parë një shfaqje të pështirë, ku lideri maksimal vendos para "togës së pushkatimit" administratën publike, e përdhunon atë live, e çnderon dhe e poshtëron dhe këtë e bën në emër të popullit. Në emër të atyre që katër vite më parë u premtoi një administratë të rilindur, që me ndihmën e Tony Blair do ta modernizonte dhe do të ndërtonte një sistem që nuk do t'i lejonte njerëzit të korruptoheshin. Ky demaskim publik që udhëheqësi po i bën një grupi të madh "armiqësor" duket edhe më i çuditshëm po të ndalesh pak dhe të pyesësh: po përse Edi Rama e ka caktuar veten nga ana e popullit? Ai ishte ai kryeministri që për katër vjet ngriti dhe ngjizi këtë administratë, duke spastruar atë që gjeti dhe duke sjellë militantët e njerëzit e tij? A duhet të kërkojë falje për dështimet, të qëndrojë me kokën ulur ashtu si drejtorët e tredhur që i mbajti për katër vite dhe para se të bëjë gjyqin e tyre, të rrëfejë të vërtetën e dështimeve të tij? Sigurisht që kryeministri nuk ka ndjeshmëri për skrupuj të tillë. Pa as më të voglin hezitim, ai kalon si pa të keq në rolin e gjykatësit të qeverisjes së tij, sikur vetë të mos kishte qeverisur asnjë ditë. Ai shndërrohet në popull, në qytetar, ndërkohë që është zgjedhur për të dhënë llogari përpara tyre dhe jo të kërkojë llogari në emër të tyre. Kur një lider merr përsipër të mishërojë edhe gjykimin qytetar, të flasë në emër të popullit, të shndërrohet në zëdhënës të masës, dhe jo të përgjigjet për detyrat që njerëzit i kanë ngarkuar me votë, nuk ka dyshim që vendi gjendet në prag të një krize të rëndë.

Kryeminstri i sapomandatuar për herë të dytë, pas mbylljes së mandatit të parë pa asnjë vepër publike, pa asnjë investim të huaj serioz, me rekorde historike në kanabizimin e vendit dhe abuzimet me paranë publike, është i vetëdijshëm se nuk mund të bëjë në katër vitet që e presin atë që nuk mundi, nuk diti apo nuk deshi të bënte katër vitet e para: përmirësimin e jetës së shqiptarëve. Prandaj në vend të premtimeve, në fushatën e fundit zgjodhi retorikën e flamujve kuqezi apo historitë e Romeos me Xhulietën e PD, dhe sot, në vend të angazhimeve serioze po organizon gjyqe popullore, ku demaskon e shkarkon live "armiqtë e popullit" në emër të popullit.

Njerëzit presin punë, investime, përmirësim të shkollave e spitaleve, rend, siguri, ujë dhe energji dhe kryeministri u jep një romake të pleniumeve të Enver Hoxhës, që kur fliste klasa dridhej burokracia. Udhëheqësi po ia shpërblen popullit besimin për timonin duke u treguar vendin drejtorëve, burokratëve, aparatçikëve që i kanë pirë gjakun pa dijeninë e tij. Sepse udhëheqësi nuk ka ditur asgjë nga këto që paskan ndodhur në qeverinë e tij, ai ka patur shumë halle mbi kokë. Veç Shqipërisë, atij i është dashur të ruajë paqen dhe prosperitetin në rajon, të këshillojë kancelaren gjermane se çfarë duhet bërë në Ballkan, të ndihmojë Vuçiçin dhe të orientojë Zaevin, të bëjë fushatë kundër Trumpit dhe të parashikojë të ardhmen e Turqisë bashkë me Erdoganin... Por tashmë, kryeministri i rizgjedhur po kthen shpresën te shqiptarët: ai po e shpartallon administratën e paaftë.

Kjo skemë bajate, që e prodhojnë liderët të cilët kanë vetëm ambicien për të qeverisur e për të dominuar por jo aftësinë për të punuar e drejtuar, po e fut vendin në një rrugë pa krye ku përgjegjësia për drejtimin e vendit nuk u kërkohet atyre që janë votuar por atyre që janë emëruar. Në fakt, kjo mund të jetë edhe ëndrra e Edi Ramës, të qeverisë por të mos marrë përgjegjësi.

A mundet një kryeministër që dështimin katërvjeçar në shëndetësi ta shesë në publik si vepër armiqësore të një grupi drejtorësh? Të gjithë e dinë që nuk ishin drejtorët ata që nënshkruan milionat e eurove për gjoja check-up falas, sterilizim, dializë, laboratorë apo për aferat e medikamenteve, pajisjeve kirurgjikale, automjeteve etj., ndërkohë që nuk u bë asnjë investim serioz në infrastrukturë për plot katër vjet. E po kështu, aferat që zbulohen çdo ditë me pronat, legalizimet, lejet e ndërtimit, zaptimin e bregdetit e hapësirave të gjelbra, nuk janë vepër e ndonjë zyrtari lokal, që linçohet në mënyrë të neveritshme përpara turmës që duartroket, por vullnet i kupolës që qeveris vendin. Strategjia e kryeministrit për të shuar etjen e qytetarëve për më shumë mirëqenie duke u hedhur kokat e prera të disa burokratëve dhe për t'i përdorur këto si koka turku për të mbuluar mëkatet e veta, është e qartë. Kryeministri po e nis mandatin e dytë duke larë duart jo vetëm nga dështimet e kaluara por edhe angazhimet e ardhshme. Udhëheqësi nuk mund të japë vetë llogari, ai vetëm e kërkon atë në emër të popullit. Ai është destinuar të mbajë timonin dhe jo të përgjigjet për destinacionin. Ata që ia besuan këtë timon, nuk është çudi të kënaqen thjesht duke ardhur vërdallë dhe duke u përmbushur me gjyqet popullore ndaj atyre që i vënë shkopinj në rrota timonierit. Treni ynë prej dekadash sillet rrotull duke na lënë në vend të fundit në garën me popujt e tjerë. Nuk mund të jetë gjithnjë një rastësi. Ne prodhojmë timonierë, por jo mjete që na çojnë përpara. *(mapo)*

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

**Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi**

**Botues: Koha Production SHPK** | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp:"Sloboden pecat" - rr. 852 nr.62, Kompleks Gazela-Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte 4 gusht | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Besim ILJAZI** | Zëvendëskryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktorë: **Shkëlzen HALIMI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

**NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772**

KOHA e lirë 61
shtojcë enigmatike e fundjavës

# SKANDI hualli




2



3



# Kakuro

(Notation: down\across clue; ■ = black cell; blank = white cell)

## e lehtë

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | ■ | 29\ | 4\ | ■ | ■ | ■ |
| ■ | 17\12 | | | 17\ | ■ | ■ |
| \23 | | | | | 11\ | ■ |
| \16 | | | 16\9 | | | 3\ |
| ■ | \15 | | | 16\3 | | |
| ■ | ■ | \21 | | | | |
| ■ | ■ | ■ | \14 | | | ■ |

## mesatare

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | ■ | ■ | 7\ | 13\ | ■ | ■ |
| ■ | ■ | \5 | | | 15\ | 14\ |
| ■ | 21\18 | | | | | |
| ■ | 17\9 | | | 10\13 | | |
| \16 | | | 12\14 | | | ■ |
| \27 | | | | | ■ | ■ |
| ■ | ■ | \7 | | | ■ | ■ |

## e vështirë

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | ■ | 28\ | 13\ | ■ | 30\ | 8\ |
| ■ | 6\5 | | | 3\10 | | |
| \34 | | | | | | |
| \4 | | | 16\9 | | | 17\ |
| ■ | 13\14 | | | 6\9 | | |
| \27 | | | | | | |
| \17 | | | \11 | | | ■ |

# Koha për enigma


B

## Mozaiku



## FJALËT ME...

**2 shkronja:** KJ, MO, MU, NA, OA, OD, OG, OL, OR, OT, TA, ZE
**3 shkronja:** ATY, ÇEL, EDHI, IMA, OTO, RAN, SON, UDHA
**4 shkronja:** ABIL, AJKA, ANAS, ATIK, AZIL, DORA, IGLI, IKJE, INDI, KAÇE, MEDA, PAQA, PIKA, RISK, STAD, SHPOJ
**5 shkronja:** AKIDO, AMTAR, ANATI, ARALI, KAREL, OLIMP, ROITA, SMIRA, SHKOQA, ULIKS
**6 shkronja:** _ _ _ _ _ _
**7 shkronja:** FENIKSI, OPERIMI
**9 shkronja:** AKADEMIKU, PARAFJALA
**10 shkronja:** BALISTIKAT, STAFILOKOK
**11 shkronja:** DOKUMENTARI, JODETYRUESE.

## Numra dhe shkronja

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 5 | 6 | 8 | 9 | 3 | 990 | | |
| | | | | | | | | |
| K | SH | I | S | M | R | J | Ë | A |
| | | | | | | | | |
| 6 | 5 | 2 | 8 | 7 | 4 | | | |
| | | | | | | | | |
| K | E | C | E | I | N | S | O | R |
| | | | | | | | | |
| 1 | 9 | 8 | 2 | 3 | 7 | 990 | | |
| | | | | | | | | |
| Ë | N | A | R | L | R | D | U | T |
| | | | | | | | | |

## Numri i njëjtë, shkronja e njëjtë

***gjeni fjalën e urtë!***

*Ndihmë: numrat 2, 5, 7 dhe 11 janë zanore!*

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 K | 2 U | 3 R | | 4 | 5 | | 6 | 7 | 8 | 9 | 5 | | 10 | 11 | 9 | 12 | 4 | 5 |
| 7 | 1 | 7 | 9 | | 13 | 11 | 9 | 4 | 5 | | | | | | | | |



### RREGULLAT

- FITON AI I CILI I PARI I GJEN TË GJITHA DETYRAT.
- Kohëzgjatja: 30 minuta. Nëse nuk ka fitues për kohën e dhënë, atëherë merren parasysh rregullat e mëposhtme:
- Mozaiku peshon 5 pikë. Zgjidhja e fjalës së urtë sjell 5 pikë. Numrat dhe shkronjat peshojnë nga 3 pikë. Nëse nuk ka zgjidhje të saktë, atëherë, te numrat, rezultati më i përafërt sjell 1 pikë, ndërsa te shkronjat, fjala me më tepër shkronja sjell 1 pikë.

KOHA e lirë GARA enigmatike


### TABELA

| | RUBRIKA | PIKËT A | PIKËT B |
|---|---|---|---|
| 1 | MOZAIKU | | |
| 2 | NUMRA DHE SHKRONJA | | |
| 3 | NUMRI I NJËJTË, SHKRONJA E NJËJTË | | |
| | GJITHSEJ | | |

KOHA e lirë GARA enigmatike

A

## Mozaiku



## FJALËT ME...

**2 shkronja:**
KJ, MO, MU, NA, OA, OD, OG, OL, OR, OT, TA, ZE

**3 shkronja:**
ATY, ÇEL, EDHI, IMA, OTO, RAN, SON, UDHA

**4 shkronja:**
ABIL, AJKA, ANAS, ATIK, AZIL, DORA, IGLI, IKJE, INDI, KAÇE, MEDA, PAQA, PIKA, RISK, STAD, SHPOJ

**5 shkronja:**
AKIDO, AMTAR, ANATI, ARALI, KAREL, OLIMP, ROITA, SMIRA, SHKOQA, ULIKS

**6 shkronja:**
_ _ _ _ _ _

**7 shkronja:**
FENIKSI, OPERIMI

**9 shkronja:**
AKADEMIKU, PARAFJALA

**10 shkronja:**
BALISTIKAT, STAFILOKOK

**11 shkronja:**
DOKUMENTARI, JODETYRUESE.

## Numra dhe shkronja

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 5 | 6 | 8 | 9 | 3 | 990 | | |
| | | | | | | | | |
| K | SH | I | S | M | R | J | Ë | A |
| | | | | | | | | |
| 6 | 5 | 2 | 8 | 7 | 4 | | | |
| | | | | | | | | |
| K | E | C | E | I | N | S | O | R |
| | | | | | | | | |
| 1 | 9 | 8 | 2 | 3 | 7 | 990 | | |
| | | | | | | | | |
| Ë | N | A | R | L | R | D | U | T |
| | | | | | | | | |

## Numri i njëjtë, shkronja e njëjtë

***gjeni fjalën e urtë!***

*Ndihmë: numrat 2, 5, 7 dhe 11 janë zanore!*

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 K | 2 U | 3 R | | 4 | 5 | | 6 | 7 | 8 | 9 | 5 | | 10 | 11 | 9 | 12 | 4 | 5 |
| 7 | 1 | 7 | 9 | | 13 | 11 | 9 | 4 | 5 | | | | | | | | | |



### RREGULLAT

- **FITON AI I CILI I PARI I GJEN TË GJITHA DETYRAT.**
- **Kohëzgjatja:** 30 minuta. Nëse nuk ka fitues për kohën e dhënë, atëherë merren parasysh rregullat e mëposhtme:
- **Mozaiku** peshon 5 pikë. Zgjidhja e **fjalës së urtë** sjell 5 pikë. **Numrat dhe shkronjat** peshojnë nga 3 pikë. Nëse nuk ka zgjidhje të saktë, atëherë, te numrat, rezultati më i përafërt sjell 1 pikë, ndërsa te shkronjat, fjala me më tepër shkronja sjell 1 pikë.

## SUDOKU "killer"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Numrat e dhëna paraqesin shumën brenda sipërfaqes me vija të ndërprera.



## SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".



## KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.



## KRIPTOGRAMI

Kriprogrami zgjidhet sipas rregullit ***"numri i njëjtë - shkronja e njëjtë"***. Për ndihmë është dhënë ndërtesa e pjerrët në Itali, me lartësi 55.86 metra, ndërtimi i së cilës filloi në gusht të vitit 1173. Pjerrtësia e kullës është 5.5 gradë.



| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | 32 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | |

## ARUKONE

Bashkoni me vija numrat e njëjtë. Vijat nuk guxojnë të priten dhe duhet të përfshihen të gjitha fushat!



## HITORI

Numrat që përsëriten duhet të nxihen, ashtu që në kolonat dhe rreshtet të mbeten numrat prej 1-9.

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 4 | 6 | 2 | 6 | 9 | 5 | 7 | 7 |
| 8 | 2 | 7 | 1 | 4 | 3 | 4 | 6 | 9 |
| 7 | 1 | 2 | 6 | 3 | 4 | 1 | 9 | 3 |
| 9 | 7 | 1 | 1 | 4 | 6 | 2 | 4 | 6 |
| 4 | 1 | 3 | 9 | 3 | 2 | 3 | 8 | 5 |
| 2 | 1 | 6 | 5 | 8 | 7 | 6 | 1 | 3 |
| 2 | 3 | 8 | 7 | 9 | 2 | 5 | 2 | 7 |
| 5 | 8 | 3 | 7 | 1 | 6 | 3 | 1 | 4 |
| 1 | 2 | 4 | 3 | 7 | 8 | 6 | 5 | 4 |

## NONOGRAM

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat me presje (rreshtet) dhe ato njëri nën tjetrin (kolonat), tregojnë se ka pauzë në mes të fushave të nxira.



## INTEGRAMI (Problemi i Ajnshtajnit)

### Dhuratat

Babai i katër fëmijëve (Mjellmat, Mirlindit, Meritës dhe Mentorit) ka vendosur t'u blejë dhurata javën që vjen edhe atë secilit në ditët e ndryshme të javës, ndërsa të premten bashkërisht do t`ë shkojnë në kinema. Fëmijët vetë i zgjodhën dhuratat (lego kocka, kukull, tren elektrik dhe pishinë). Dhuratat u blenë në shitoret e ndryshme: në atë angleze, gjermane, franceze dhe shqiptare. Gjeni se cili fëmijë, cilën ditë dhe çfarë dhurate ka fituar?!




*Të dhënat:*

1. Merita nuk e zgjodhi as pishinën as lodrat lego.
2. Djemtë nuk e zgjodhën kukullën.
3. Shitoren franceze e vizituan para se ta zgjidhte Mirlindi dhuratën, ndësa Mirlindi dhuratën e tij e zgjodhi një ditë para se të blehet treni elektrik.
4. Mjellma nuk deshi dhuratë nga shitorja gjermane.
5. Tre ditë me radhë u blenë këto dhurata (por jo me këtë renditje): njëra në shitoren angleze, dhurata të cilën e zgjodhi Merita dhe kukulla.
6. Lodrat lego u blenë pas vizitës së shitores franceze, por para kukullës.
7. Dhurata e Meritës nuk u ble dy ditët e para të javës.
8. Lodrat lego u blenë një ditë para dhuratës së Meritës.

**TABELA**

| | DITA | LODRA | SHITORJA |
|---|---|---|---|
| Merita | | | |
| Mentori | | | |
| Mjellma | | | |
| Mirlindi | | | |

# Sudoku

## i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 6 | 3 | | 4 | | 2 | 1 | |
| | | | | 6 | | | | |
| | | | 8 | | 3 | | | 9 |
| | | 5 | | | | 9 | | |
| 3 | 4 | | | 9 | | | 7 | 8 |
| | | 6 | | | | 4 | | |
| 4 | | | 5 | | 6 | | | 3 |
| 6 | | | | 8 | | | | 4 |
| | | 1 | | 2 | | | | |

## mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 7 | | | | | | 4 | |
| 2 | | | 4 | | | | | 8 |
| | | 4 | | 2 | | 1 | | |
| 7 | | | 8 | | 1 | | | 9 |
| | 8 | 2 | | | | 6 | 1 | |
| | | 1 | 9 | | 2 | 4 | | |
| | | 9 | | 8 | | 3 | | |
| 6 | | | 3 | | | | | 4 |
| | 2 | | | | | | 7 | |

## i vështirë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | | | | | 6 | |
| | | | | 2 | 8 | 7 | | |
| 7 | | | 6 | | | | | 9 |
| | 9 | | 1 | | 3 | 5 | | |
| | 2 | | | 7 | | | 4 | |
| | | 8 | 2 | | 6 | | 3 | |
| 4 | | | | | 5 | | | 6 |
| | | 6 | 7 | 9 | | | | |
| | 3 | | | | | 8 | | |



## MENSUR MAMUTI

- KLUBI I KARATESË / SHAPKA / BIG MAMA, BESJANA
- SHËRBYESIT FETAR / VRASJA APO VJEDHJA
- J
- GADISHULL NË AMERIKËN VERIORE / EMËR MASHKULLI
- LËSHOHET NË PISTË
- VENDVDEKJA E N.T.
- LLOJ I TË QËLLUARIT NË BOKS
- FILMA ME VAZHDIME / UDHËTAR I RASTIT
- K
- KAFE ME QUMËSHT TË FTOHTË
- IMPULS
- SHKRONJA E 8-të / BIZNESMENI KOSOVAR, RAMADANI
- AZOT / I BËNË SHKALLË SHKALLË
- NORVEGJI / BIXHOZ

## KOHA E LIRË

- NËNË TEREZA
- ZERO CELSUS / PERSONAZH NGA BIBLA / PUNONJËS I ARËS
- VLERËSOJ, ÇMOJ / NJËSI E GJATËSISË
- ENERGJI
- HIGHER TECHNOLOGICAL INSTITUTE / KATRAN
- KALIUM / POSEDON
- POLITIKANI MAJKO
- HEROINA TERBESHI
- VENDLINDJA E N.T. / KËNDI NËMES DREJT. TË LEV. DHE VERIUT
- GOJORE
- SHKRETËTIRË NË KILI / SKUQJE E MUKOZES (zgjerim i kapil.)
- SHIH FOTON
- ANKONA / FILM SERIK AMERIKAN 6 SEZONËSH
- XH.P.
- TITULL FISNIK ANGLEZ / FLUOR
- ZOTËRI (evropianët i thirrnin anglezët e klasës së lartë) / BAN. I KORESË
- ME PLOT EUFORI
- PJELLË E PELËS / LLOJ QENI (shq.)
- SPANJË / VEND NË RESNJË
- B.N.
- JOD / MËNYRAT E TË SHKRUARIT
- LLOJ SHKOPI PËR DAULLE / BUKUROSHE
- ALBANIA / PËRMBYLLJE, ZGJIDHJE E DIÇKAJE
- OREGON UNIV. SYSTEM / U KA KALUAR KOHA / VIOLETË KUKAJ
- MERITORI / PJESË E BOKSIT
- AMERICAN PLANNING ASSOCIATION / VEND NË SPANJË
- KLUB, SKUADËR
- PARAPAGIME / NJË NDAJFOLJE
- KLEJ (Muhamed Ali) / FUTB. FRANC. ZIDAN
- KUFTA NACIONALE / NUMËR (shkurt.)
- HAPJA E REKTUMIT / QYTET HISTORIK NË AZI TË VOGËL
- HARK, KTHESË / M.A.
- Z
- OMOTITJE; THASHETHEME / AUSTRI
- SJELLJA E URTË
- ATDHETARI NGA LIPJANI, JASHARI (u ekzekutua nga serbet)

# ZGJIDHJET

## SKANDI HUALLI

## KAKURO

## GARA ENIGMATIKE

### MOZAIKU

**NUMRA DHE SHKRONJA:** 3-1=2, 8+2=10, 9x10=90, 5+6=11, 90x11=990. SKAJSHMËRI. 9x2=18, 7x18=126, 126-1=125, 125x8=1000. SEKRECION. 8+2+1=11, 9x11=99, 7+3=10, 99x10=990. LUNDËRTAR.

**NUMRI I NJËJTË SHKRONJA E NJËJTË:** Kur të vijnë mendtë ikin dhentë.

## SKANDI



## KRIPTOGRAMI



## SUDOKU

### i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 6 | 3 | 7 | 4 | 9 | 2 | 1 | 5 |
| 5 | 9 | 4 | 1 | 6 | 2 | 3 | 8 | 7 |
| 2 | 1 | 7 | 8 | 5 | 3 | 6 | 4 | 9 |
| 1 | 7 | 5 | 4 | 3 | 8 | 9 | 6 | 2 |
| 3 | 4 | 2 | 6 | 9 | 1 | 5 | 7 | 8 |
| 9 | 8 | 6 | 2 | 7 | 5 | 4 | 3 | 1 |
| 4 | 2 | 8 | 5 | 1 | 6 | 7 | 9 | 3 |
| 6 | 5 | 9 | 3 | 8 | 7 | 1 | 2 | 4 |
| 7 | 3 | 1 | 9 | 2 | 4 | 8 | 5 | 6 |

### mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 7 | 3 | 6 | 9 | 8 | 5 | 4 | 2 |
| 2 | 6 | 5 | 4 | 1 | 3 | 7 | 9 | 8 |
| 8 | 9 | 4 | 7 | 2 | 5 | 1 | 3 | 6 |
| 7 | 4 | 6 | 8 | 3 | 1 | 2 | 5 | 9 |
| 9 | 8 | 2 | 5 | 7 | 4 | 6 | 1 | 3 |
| 5 | 3 | 1 | 9 | 6 | 2 | 4 | 8 | 7 |
| 4 | 5 | 9 | 2 | 8 | 7 | 3 | 6 | 1 |
| 6 | 1 | 7 | 3 | 5 | 9 | 8 | 2 | 4 |
| 3 | 2 | 8 | 1 | 4 | 6 | 9 | 7 | 5 |

### i vështirë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 8 | 1 | 9 | 3 | 7 | 4 | 6 | 5 |
| 9 | 6 | 4 | 5 | 2 | 8 | 7 | 1 | 3 |
| 7 | 5 | 3 | 6 | 1 | 4 | 2 | 8 | 9 |
| 6 | 9 | 7 | 1 | 4 | 3 | 5 | 2 | 8 |
| 3 | 2 | 5 | 8 | 7 | 9 | 6 | 4 | 1 |
| 4 | 7 | 2 | 3 | 8 | 5 | 1 | 9 | 6 |
| 1 | 4 | 8 | 2 | 5 | 6 | 9 | 3 | 7 |
| 8 | 1 | 6 | 7 | 9 | 2 | 3 | 5 | 4 |
| 5 | 3 | 9 | 4 | 6 | 1 | 8 | 7 | 2 |

## INTEGRAMI

## SUDOKU "killer"

## SUDOKU ">"

## KENKEN

## ARUKONE

## HITORI

## NONOGRAM



Sipas studiuesve shkaku për këtë mund të jenë celularët që mbajnë burrat në xhep, pirja e duhanit apo disa lloj ilaçesh. Në periudhën1973-2011 numri i spermatozoideve për çdo derdhje sperme ka rënë me rreth 52.4 për qind



# Trump do të përgjysmojë dhënien e Green Cards

Presidenti amerikan, Donald Trump planifikon një ndryshim të ligjeve të imigracionit në SHBA, që prekin lejet e përhershme të qëndrimit në Amerikë, të ashtuquajturat Green Cards. Ato do të ulen ndjeshëm në vetëm 500.000 leje në vit. Kjo do të thotë përgjysmimi i lejeve që janë dhënë deri më tani.

Në Shtëpinë e Bardhë, Trump bëri fjalë për "një nga reformat më të rëndësishme të sistemit të imigrimit brenda një gjysmë shekulli". Ligji parashikon që në të ardhmen, dhënia e Green Card-eve të bëhet në bazë të një sistemi pikësh si në Australi e Kanada, të cilat vlerësojnë aftësitë e kandidatëve. Trump tha, se sistemi i ri do të vlerësojë ata të huaj që flasin mirë anglisht, kanë cilësi profesionale të caktuara dhe që mund të kujdesen për veten e fëmijët e tyre, tha Trump. Trump kritikoi sistemin e deritanishëm, që jepet me llotari ose që preferon vetëm ata të huaj, që kanë lidhje familjare me SHBA-në.

Në këtë mënyrë vijnë në vend shumë të huaj të huaj të pakualifikuar, që u marrin punën amerikanëve. Sipas Trump kjo rëndon "punëtorët amerikanë, taksapaguesit dhe burimet e komunave". Nëse në të ardhmen vijnë më pak të pakualifikuar që shtyhen në tregun amerikan të punës, kjo krijon shanse për punëtorët amerikanë. Projektligji i ri i përgatitur nga senatorët Tom Cotton dhe David Perdue parashikon shpërndarjen e më pak lejeve të qëndrimit për refugjatët deri në 50.000 në vit.

# Ardhmëria evropiane e Polonisë, e pasigurt

Kryetari i Këshillit të Evropës Donald Tusk, mbrëmë deklaroi se ardhmëria evropiane e Polonisë është e pasigurt. "Ardhmëria evropiane e Polonisë sot është në pikëpyetje. I kuptoj ndjenjat e polakëve, të cilët druajnë për gjykatat dhe për të ardhmen e vendit në Bashkimin Evropian", theksoi Tusk, i cili është ish-kryeministër i Polonisë. Qeveria e Tusk dhe partia centriste "Platforma qytetare" ishte në pushtet tetë vite, ndërsa në vitin 2015 u ndërrua nga partia konservatore populiste E drejta dhe drejtësia, e kryesuar nga Jarosllav Kaçinski, vëllai binjak i presidentit të ndjerë Leh. Ai angazhohet për vendosjen e reformave radikale. Një pjesë e polakëve vlerësojnë se sistemi gjyqësor është korruptuar dhe ngjason me atë nga epoka komunikste, ndërsa të tjerët mendojnë se reformat e "E drejta dhe drejtësia" janë tentim për forcimin e pushtetit, me të cilët prishen normat demokratike. "Ka shumë çështje për të cilat procedurat e Qeverisë polake duken shumë kontradiktore nga pikëpamja e BE-së, ndërsa ndonjëherë duke e përfshirë edhe Budapestin", theksoi Tusk.




# Rënie dramatike e spermatozoideve tek meshkujt perëndimorë

**Shkencëtarët konstatojnë gjithnjë e më pak spermatozoide në farën e meshkujve nga vendet perëndimore. Cilat janë shkaqet?**

Në spermën e meshkujve nga vendet e zhvilluara në Evropë, në Amerikën e Veriut, në Australi dhe Zelandën e Re gjenden gjithnjë e më pak spermatozoid. Sipas studiuesve shkaku për këtë mund të jenë celularët që mbajnë burrat në xhep, pirja e duhanit apo disa lloj ilaçesh. Në periudhën1973-2011 numri i spermatozoideve për çdo derdhje sperme ka rënë me rreth 52.4 për qind. Në këtë përfundim kanë arritur studiuesit e Universitetit Hebrew University në Jerusalem. Në artikullin e botuar në revistën shkencore "Human Reproductive Update" studiuesit shkruajnë se tek meshkujt nga Azia, Afrika dhe Amerika e Jugut nuk kanë konstatuar ndonjë rënie dramatike të spermatozoideve tek sperma e meshkujve.

## PËR T'U SHËNUAR, POR JO SHKAK PËR PANIK

Prof. Dr. Stefan Schlatt, drejtor i qendrës për mjekësinë riprodhuese dhe andrologjinë pranë Universitetit të Mynsterit tha në intervistë për DW se rënia e spermatozoideve është sidomos për t'u shënuar për periudhën 1970-1990, por është ende "në një nivel që Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron si normale". Rreziku për të mos qenë në gjendje për të lënë një femër me barrë nis në rast se një mashkull lëshon me pak se 15 milionë spermatozoide për çdo derdhje sperme. Nga ana tjetër, prof. dr. Stefan Schlatt, thotë se gjatë 10-15 viteve të fundit gjendja duket se është stabilizuar sërish.

Në lidhje me faktorët që kanë çuar në rënien e spermatozoideve në farën e meshkujve, shkencëtarët deri tani vetëm mund të spekulojnë dhe shpjegimet e tyre tingëllojnë mjaft zbavitëse: "Ndoshta meshkujt në vendet perëndimore shohin shumë gra lakuriq, dhe hipotalamusi i tyre merr më tepër informacione se dikur," spekulon prof. dr. Stefan Schlatt, "ose pelenat (pampersat) kanë qenë shumë të ngushta dhe kanë prodhuar shumë nxehtësi".

"Ndoshta ilaçe të tilla si aspirina apo paracetamoli mund të ketë efekt negativ ndaj qelizave mashkullore. Por gjithashtu ndoshta edhe telefonat celularë ndikojë tek organet mashkullore. Por mund të jenë edhe të gjithë faktorët së bashku, këtë nuk e dimë", thotë prof. dr. Schlatt. Megjithatë ajo që është e njohur, është se pirja e duhanit nuk bën mirë për spermën. Prof. Dr. Artur Mayerhofer, nga Universiteti Ludwig Maximilians në Mynih, thotë se e merr shumë seriozisht studimin për rënien e numrit të spermatozoideve, sepse tek meshkujt në vendet e zhvilluara perëndimore vihet re një shtim i sëmundjeve tek organet gjenitale, si kanceri i testikujve, apo anomali të tjerave të herdheve. Ai thotë se gjëndrat që prodhojnë spermatozoidet janë tepër të ndjeshme dhe kushtet dhe stili i jetesës ndikon ndaj tyre.

## PROBLEMI MË I MADH FEMRAT

Për një gjë të paktën meshkujt mund të jenë të qetë në egon e tyre.

Problemi më i madh në vendet perëndimore, thonë ekspertët e mjekësisë riprodhuese, nuk është infertiliteti mashkullor. Mjekët thonë se më shumë shqetësim përbëjnë për ta gratë që duan të lindin fëmijë gjithnjë e më vonë. Po ashtu në studimin për rënien e spermatozoideve nuk qe trajtuar një çështje e rëndësishme: sa të shpejtë dhe aktivë ishin spermatozoidet. Sepse i rëndësishëm nuk është vetëm numri i spermatozoideve në spermë, por që në fund të fundit njëri prej tyre të arrijë të depërtojë vezën.

*(DW)*

# Refugjatët po dhunohen nga policët

**Vazhdojnë diskutimet për kushtet e vështira me të cilat ballafaqohen refugjatët në kampet në Francë, për keqtrajtimet dhe dhunën policore e cila tani është shndërruar në sistematike**

Vazhdojnë diskutimet për kushtet e vështira me të cilat ballafaqohen refugjatët në kampet në Francë, për keqtrajtimet dhe dhunën policore e cila tani është shndërruar në sistematike, si dhe mbi ndalesat për sjelljen e ndihmave. Sipas informacioneve që ka siguruar Anadolu Agency, refugjatët në Francë ballafaqohen me kushte të vështira jetësore, ndërsa në të njëjtën kohë i nënshtrohen dhunës së policisë. Në kampin "Xhungël" i cili ndodhet në veri të Francës shihet se refugjatët nuk kanë kushte të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat themelore të refugjatëve të cilët ndodhet në këtë kamp. Pas vendimit të qeverisë për shpërndarjen e këtij kampi, një pjesë e refugjatëve të cilët u dërguan në qendra të ndryshme, u kthyen në kamp për shkak të kushteve të vështira dhe mungesës së kapaciteteve në ato vende. Refugjatët në rajon po përpiqen të jetojnë në pyje pa kushtet themelore për




jetesë, gjësendet për të fjetur, tualetit, banjos dhe ushqimit. Refugjatët në Francë në njërën anë ballafaqohen me kushte të vështira të jetës, në anën tjetër përballen me dhunën e policisë ndaj tyre. Në raportin e formuar nga Organizata për të Drejtat e Njeriut Human Rights Watch (HRW), raport i përgatitur nga intervistat e zhvilluara me refugjatët të cilët ndodhen në Calais dhe në rrethinë, thuhet se policia franceze në mënyrë rutinore ka përdorur gaz lotsjellës ndaj refugjatëve derisa ata ishin në gjumë ose ishin të padëmshëm, pa bërë dallim të fëmijëve ose të rriturve. Duke vënë në dukje se policia franceze ka hedhur gaz lotsjellës edhe në ushqimet dhe pijet për ta lënë Calaisin, në raport theksohet se sjelljet e tilla të policisë janë jonjerëzore dhe në kundërshtim me të drejtat ndërkombëtare. Përkundër kushteve të vështira dhe dhunës së policisë, janë ndërmarrë masa të ndryshme për parandalimin e krijimit të një kampi tjetër, ndërkaq zyrtarët kanë ndaluar ndihmat për refugjatët. Sipas raportit të HRW-së, pas kthimit të refugjatëve në kampin në Calais, zyrtarët vendas kanë ndaluar që ata t'i përmbushin nevojat themelore të tyre si ushqimi dhe pija. Në anën tjetër, organizatat e ndihmave kishin vendosur në këto kabina për dush, por forcat e sigurisë nuk lejuan që refugjatët t'i shfrytëzojnë ato si dhe që të bëhet shpërndarja e ushqimit dhe pijeve. Pas shpërndarjes së kampit të refugjatëve "Xhungël" rreth 3 mijë refugjatë vendosën tenda përreth stacioneve të metrosë në rajone të ndryshme të Parisit, por policia në muajin tetor të vitit të kaluar i largoi ato.

Republika e Maqedonisë
**Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave**

Në bazë të nenit 21-a paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës s Maqedonisë" nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 02/17 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 100/17), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërav publikon

## SHPALLJE PUBLIKE nr. 02/17
## Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik

### 1. LËNDË E SHPALLJES PUBLIKE

Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **595ha 40ar 38m$^2$** në rajonet në vijim të Republikës së Maqedonisë:

**Pasqyre e përmbledhur sipas rajoneve**

| Numri rendor | Rajon | Ha | Ar | m$^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Vinicë | 12 | 48 | 74 |
| 2 | Manastir | 17 | 07 | 23 |
| 3 | Gjevgjeli | 40 | 59 | 11 |
| 4 | Resnjë | 9 | 72 | 44 |
| 5 | Strugë | 15 | 54 | 76 |
| 6 | Kavadar | 374 | 04 | 79 |
| 7 | Kratovë | 24 | 19 | 44 |
| 8 | Koçan | 101 | 73 | 87 |
| **GJITHSEJ** | | **595** | **40** | **38** |

**Rajoni Vinicë**

| Tërësia gjeografike 1 | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Istibanja | 8 | 31 | 19 | 833,00 |
| 2 | Peklani | 4 | 17 | 55 | 250,00 |
| **Gjithsej** | | **12** | **48** | **74** | |

**Rajoni Manastir**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Agllarcë e E. | 7 | 07 | 23 | 424,00 |
| 2 | Srpci i Poshtëm | 10 | 00 | 00 | 900,00 |
| **Gjithsej** | | **17** | **07** | **23** | |

**Rajoni Gjevgjeli**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Crniçan | 7 | 18 | 82 | 431,00 |
| 2 | Negorc | 3 | 94 | 20 | 237,00 |
| 3 | Negorc | 5 | 69 | 91 | 513,00 |
| 4 | Sermenin | 5 | 32 | 88 | 320,00 |
| 5 | Sermenin | 14 | 92 | 38 | 895,00 |
| 6 | Sermenin | 3 | 50 | 92 | 211,00 |
| **Gjithsej** | | **40** | **59** | **11** | |

**Rajoni Resnjë**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Dupeni i E. | 9 | 72 | 44 | 875,00 |
| **Gjithsej** | | **9** | **72** | **44** | |

**Rajoni Strugë**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Misleshevë –jashtë r. n | 10 | 00 | 00 | 1.200,00 |
| 2 | Misleshevë –jashtë r. n | 5 | 54 | 76 | 666,00 |
| **Gjithsej** | | **15** | **54** | **76** | |

**Rajoni Kavadar**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Stragovë | 17 | 28 | 95 | 1.037,00 |
| 2 | Stragovë | 13 | 62 | 25 | 817,00 |
| 3 | Stragovë | 6 | 66 | 27 | 400,00 |
| 4 | Stragovë | 23 | 18 | 23 | 1.391,00 |
| 5 | Stragovë | 33 | 89 | 71 | 2.034,00 |
| 6 | Stragovë | 22 | 52 | 86 | 1.352,00 |
| 7 | Stragovë | 12 | 39 | 78 | 744,00 |
| 8 | Stragovë | 16 | 52 | 93 | 992,00 |
| 9 | Stragovë | 20 | 38 | 01 | 1.222,00 |
| 10 | Stragovë | 22 | 33 | 23 | 1.340,00 |
| 11 | Boshava | 31 | 70 | 99 | 1.903,00 |
| 12 | Boshava | 6 | 24 | 00 | 374,00 |
| 13 | Bojançishte | 4 | 81 | 14 | 289,00 |
| 14 | Bojançishte | 7 | 52 | 87 | 452,00 |
| 15 | Bojançishte | 4 | 24 | 87 | 255,00 |
| 16 | Mrzen Oraovec | 8 | 43 | 71 | 389,00 |
| 17 | Mrzen Oraovec | 3 | 33 | 34 | 200,00 |
| 18 | Mrzen Oraovec | 34 | 50 | 34 | 1.035,00 |
| 19 | Garnikovë | 39 | 49 | 46 | 2.370,00 |
| 20 | Garnikovë | 4 | 53 | 19 | 272,00 |
| 21 | Garnikovë | 7 | 06 | 93 | 424,00 |
| 22 | Garnikovë | 13 | 72 | 93 | 824,00 |
| 23 | Garnikovë | 16 | 56 | 72 | 994,00 |
| 24 | Sopot | 3 | 02 | 08 | 181,00 |
| **Gjithsej** | | **374** | **04** | **79** | |

**Rajoni Kratovë**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Konjuf | 24 | 19 | 44 | 2.157,00 |
| **Gjithsej** | | **24** | **19** | **44** | |

**Rajoni Koçan**

| Tërësia gjeografike | Komuna katastrale | Sipërfaqja | | | Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ha | ar | m$^2$ | |
| 1 | Lepopellc | 34 | 41 | 67 | 2.065,00 |
| 2 | Lepopellc | 6 | 68 | 97 | 401,00 |
| 3 | Lepopellc | 20 | 66 | 11 | 1.240,00 |
| 4 | Lepopellc | 5 | 94 | 90 | 535,00 |
| 5 | Lepopellc | 7 | 00 | 00 | 420,00 |
| 6 | Koçan | 8 | 21 | 10 | 986,00 |
| 7 | Koçan | 11 | 11 | 89 | 1.334,00 |
| 8 | Orizari | 4 | 60 | 29 | 276,00 |
| 9 | Sokollarcë | 3 | 09 | 94 | 280,00 |
| **Gjithsej** | | **101** | **73** | **87** | |

Të dhënat për tokën bujqësore lëndë e kësaj shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përmbajtura në listën pronësore) janë në pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilën sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësinë periferike të Ministrisë, ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.

Listat me indikacionet katastrale të tokës që e identifikojnë janë dhënë në pasqyrat e detajuara si shtojcë e shpalljes.

Qëllimi për të cilin jepet toka bujqësore në pronësi të shtetit me qira përmes shpaljes publike është për:
- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare (vreshta, pemishte, kmelj) dhe oranzheri për periudhë deri më 30 vjet,
- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare me lajthi për periudhë prej 70 vjetëve,
- ngritje të ullishtave për periudhë deri më 50 vjet,
-kultivim të kulturave të tjera bujqësore për periudhë deri më 15 vjet,
- livadheve për periudhë deri më 15 vjet,
- për kultivimin e drunjve që rriten shpejtë në tok[ën bujqësore e cila gjendet në lartësi mbidetare mbi 700 metra, për periudhë prej 30 vjet,
- baseneve të peshqve deri në 20 vjet dhe
- aktiviteteve sportive-rekreative dhe turizëm rural deri në 30 vjet.

### II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.

Subjektet fizike duhet të jenë realizues të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.

Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.

Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore tu jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.

Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik, janë të obliguar që të dorëzojnë:

**a) për subjektet juridike:**
- fletëparaqitje (formulari është dhënë i bashkëngjitur në faqen e MBPEU ose mund të merret në njësinë rajonale të Ministrisë);
- dëshmi (akt) të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik (nëse subjekti aplikon me filial është e nevojshme që dokumenti i dhënë nga regjistri qendror të përmbajë të dhëna për veprimtarinë kryesore të subjektit juridik dhe të filialit);
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
- biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin e të punësuarve, aspektet e tregut, pritshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të jetë i nënshkruar në secilën faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose personit të autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizimit të vërtetuar në noter);
-deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përmbushur obligimet nga ajo marrëveshje;

- garanci bankare për pjesëmarrje në shpalljen publike në shumë të qirasë së ofruar nëntëmujore dhe
- dëshmi për pajisje materiale – teknike (leje qarkullimi, fatura, marrëveshje për shitblerje, të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt i ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet themelor për përpunimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).

**b) për subjektet fizike:**
- fletëparaqitje (formulari është dhënë i bashkëngjitur në faqen e MBPEU ose mund të merret në njësinë rajonale të Ministrisë);
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
- fotokopje të letërnjoftimit;
- vërtetim për regjistrim në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore ose vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga Regjistri qendror për regjistrim si tregtar i vetëm;
- program për shfrytëzimin e tokës i cili përmban të dhëna elementare për familjen, përgatitjen teknike-teknologjike, qëllimin për të cilën do të përdoret toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);
- deklaratë për besueshmërinë e të dhënave të dhëna në fletëparaqitje e vulosur në noter;
-deklaratë të vulosur në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës të personit juridik i cili ka përdorur tokë bujqësore me qira në pronësi të shtetit ndërsa nuk i ka plotësuar obligimet e asaj marrëveshje;
- garanci bankare për pjesëmarrje në shpalljen publike në shumë të qirasë së ofruar nëntëmujore dhe
- dëshmi për pajisje materiale – teknike (leje qarkullimi, fatura, marrëveshje për shitblerje, të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt i ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet themelor për përpunimin e tokës bujqësore (marrëveshje prë lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).

Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.

Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të jetë e plotësuar tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme <u>në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.</u>

**Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se:**
- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;
- janë dorëzuar pas afatit të caktuar për tu dorëzuar;
- janë të dorëzuara në zarf të shënuar me të cilin do të mundej të identifikohet ofertuesi;
- janë të parashtruara nga personi që nuk ka të drejtë të parashtrojë oferta dhe
- nuk janë hartuar sipas kushteve të caktuara në thirrjen publike **komisioni i hedhë si të pakompletuara.**

Ofertat për tokën bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën me detyrë administrative Komisioni do të vërtetojë se nuk janë kryer obligimet nga marrëveshjet e lidhura më herët, Komisioni do ti hedhë si **të palëshuara.**

Ofertat për tokë bujqësore në pronësi të shtetit për të cilat Komisioni do të vërtetojë se një ofertues ka dorëzuar më shumë se një ofertë, Komisioni do ti hedhë si **të palëshuara.**

Oferta e cila do të dorëzohet me qira më të ulët të ofruar se qiraja minimale e përcaktuar në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë si **të palëshuar.**

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit në lidhje me thirrjen publike nuk do të shqyrtohen ndërsa ofertuesit do të informohen për pakompletësinë në mënyrë elektronike në **e-mail adresën** e dorëzuar.

Kushtet e parapara në biznes planin (për personat juridik), respektivisht aspektet e tregut të parapara në program (te personat fizik) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime kontraktuale të cilat obligohet ti përmbush në vëllimin, afatet dhe mënyrën se si do të jenë të përshkruara në shpalljen publike.

**III. KRITERET PËR ZGJEDHJE TË OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM**

Komisioni kryen zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm në bazë të nenit 4 të Rregullores për kriteret më të përafërta për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund të jepet me qira dhe përcaktim të madhësisë së sipërfaqes së tokës bujqësore që mund të jepet me qira (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 12/06, 26/12, 2/13, 158/13, 120/15, 129/15 dhe 27/16).

Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën mund të parashtrohet fletëparaqitje dhe e cila mund ti jepet me qira një pjesëmarrësi, përcaktohet në bazë të pajisjes minimale materiale-teknike të ofertuesit dhe numrin e të punësuarve të planifikuar gjegjësisht të punëtorëve sipas biznes planit edhe atë:
- për sipërfaqe deri në 50 ha – së paku 1 traktor të kategorisë së lehtë (deri në 80kv) dhe së paku një të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-за për sipërfaqe deri më 100ha – së paku 2 traktorë të kategorisë së lehtë (deri në 80kv) ose së paku 1 të kategorisë së mesme (prej 80 deri në 120kv) dhe së paku 2 të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-për sipërfaqe deri më 150ha – së paku 4 traktorë të kategorisë së lehtë (deri 80kv) ose së paku 2 të kategorisë së mese ose së paku 1 të kategorisë së rëndë (mbi 120kv) dhe së paku 4 të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-për sipërfaqe mbi 150 hektarë, numri/kapaciteti i mekanizmit të rritet proporcionalisht me madhësinë e sipërfaqes e cila do të punohet dhe në çdo 50 hektarë të planifikohet nga një punëtor në marrëdhënie të rregullt pune.

**IV. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË**

**Në shpalljen publike secili ofertues mund të parashtrojë vetëm një formular (ofertë) në origjinal, ndërsa mund të aplikojë për një, dy, tri ose më shumë tërësi gjeografike dhe rajone.**

**V. GARANCIA BANKARE PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË**

Garanci bankare për pjesëmarrje në procedurë do të duhet të dorëzojnë të gjithë ofertuesit në shpallje edhe atë së bashku me fletëparaqitjen.

Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë duhet të jetë **e pakushtëzuar, e pakthyeshme dhe e pagueshme** në thirrjen e parë me afat prej 120 ditëve duke llogaritur nga dita e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpallje publike.

Garancia bankare duhet të jepet nga banka me seli në Republikën e Maqedonisë.

Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë ofertuesit të zgjedhur do t'i kthehet pasi të nënshkruajë marrëveshjen dhe do të dorëzojë garanci bankare për për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes.

Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë paguhet nëse:
- ofertuesi i zgjedhur refuzon të nënshkruajë marrëveshjen në pajtim me kushtet e shpalljes publike ose nënshkrimin e marrëveshjes e kushtëzon me ndryshime ose plotësime që nuk parashihen në shpallje,
- pjesëmarrësi gjatë procedurës tërheqë ofertën ose
- ofertuesi i zgjedhur nuk dorëzon garanci bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes.

Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë në rast të aktivizimit paguhet në:
- llogarinë trezore të Republikës së Maqedonisë;
-banka e pranuesit: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;
-llogaria: 100000000063095;
-llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 630010001963019;
-shifra e të hyrave: 725933 (Të hyrat nga garancitë e aktivizuara bankare).

**VI. MËNYRA DHE PROCEDURA E REALIZIMIT TË ANKANDIT PUBLIK**

Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm në procedurën sipas shpalljes publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik, realizohet në bazë të qirasë më të lartë të ofruar vjetore për hektar për tërësinë gjeografike të arritur përmes ankandit publik elektronik.

Procedura për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqet mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik mund të realizohet edhe nëse në të ka marrë pjesë edhe një ofertues dhe ofron shumën mbi çmimin fillestar.

Shuma fillestare e ankandit publik elektronik është në shumë të çmimit fillestar për një tërësi gjeografike të caktuar në vet shpalljen publike.

Komisioni për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit përmes ankandit publik elektronik në afat prej tre ditëve pas kalimit ë afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve, përmes formës elektronike informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në shpalljen publike për kompletimin dhe përkatësinë e fletëparaqitjes në pajtim me kushtet nga shpallja publike, gjatë së cilave ofertuesve që kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar dhe përkatëse u dorëzon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa ofertuesve të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të pakompletuar ose jopërkatëse u dërgon lajmërim se të njëjtat nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

Ofertuesit të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar dhe përkatëse, në ditën e ankandit publik, regjistrohen në internet faqen e shënuar në shpallje me emrin përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, pas së cilës kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.

Ofertuesit së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë edhe **e-mail adresën** e tyre në të cilën do të informohen nga ana e Komisionit për datën dhe orën e fillimit të ankandit publik elektronik.

Regjistrimin në ankandin publik elektronik ofertuesit e bëjnë në
http://62.220.210.66:8080/auction.

Ankandi publik elektronik fillon me publikimin e çmimit fillestar për hektar të tokës bujqësore lëndë për qira, ndërsa realizohet përmes ankandit nga ana e pjesëmarrësve në ankandin publik.

Për procedurën e realizuar me sukses të ankandit publik është e nevojshme të ketë së paku një licitacion në nivel jo më të ulët se 5% e çmimit të përcaktuar fillestar të qirasë vjetore mbi çmimin fillestar për hektar.

Ankandi publik nuk guxon të zgjasë më shkurt se 15 minuta. Ankandi publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit ë kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për zgjatje të ankandit publik, nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë e re, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën e ardhshme prej dy minutave nuk jepet ofertë e re.

Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re jo më të ulët se 5% të ofertës së fundit të dorëzuar.

Komisioni për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit përmes ankandit publik elektronik pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik dhe në mënyrë elektronik e dorëzon deri tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik.

Ofertuesi i zgjedhur më i volitshëm është personi pjesëmarrës në ankandin publik elektronik i cili ka ofruar çmimin e fundit dhe që është edhe çmimi më i lartë i arritur për hektar të ofruar në ankandin publik elektronik.

Procedura për ankandin publik përfundon pas kalimit të afatit për parashtrim të ankesës nëse nuk është parashtruar asnjë ankesë gjegjësisht deri në sjelljen e vendimit në lidhje me ankesën nëse nuk është parashtruar ankesë kundër vendimit, ndërsa nëse është parashtruar ankesë kundër vendimit, pas plotfuqishmërisë së vendimit.

Pas plotfuqishmërisë së vendimit në afat prej 30 ditëve ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave me ofertuesin e zgjedhur më të volitshëm do të lidhë marrëveshje për qira të tokës bujqësore, i cili në afat prej 15 ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes është i obliguar të dorëzojë Garanci bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të obligimeve nga marrëveshja që duhet të jetë e pakushtëzuar, e pakthyeshme dhe e pagueshme në ftesë të parë në shumë prej qirasë nëntëmujore dhe është 5% të investimeve të planifikuara në ofertën e ofertuesit të zgjedhur, por jo më pak se shuma e qirasë nëntëmujore. Garancia bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes duhet të jetë valide për tërë periudhën të kohëzgjatjes së marrëveshjes, ndërsa do të rinovohet në çdo tre vjet.

Ofertuesi më i volitshëm të cilin lidhet marrëveshja për qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit është i obliguar qiranë ta paguajë deri më 31 korrik të vitit aktual për vitin e kaluar, duke llogaritur nga dita e futjes përmes procesverbalit në posedim të tokës bujqësore lëndë e marrëveshjes.

Marrëveshja për qira e lidhur me ofertuesin e zgjedhur të volitshëm futet në fuqi me ditën e futjes së pronësisë së qiramarrësit ndaj tokës bujqësore lëndë e marrëveshjes nga ana e qiradhënësit edhe atë vetëm për sipërfaqet për të cilët është futur në pronësi faktike.

**VII. ÇMIMI FILLESTAR**

Çmimi fillestar për hektar në procedurë të kësaj shpallje publike përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës. Çmimi fillestar për tokën bujqësore prej:
- klasës katastrale I dhe II është 120 euro,
- klasës katastrale III dhe IV është 90 euro,
- klasës katastrale V dhe VI është 60 euro dhe
- klasës katastrale VII dhe VIII është 30 euro, në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë të paguar në ditën e pagesës.

Nëse toka bujqësore gjendet mbi 1000 lartësi mbidetare çmimi fillestar i qirasë për tokën bujqësore prej:
- klasës katastrale I dhe II është 60 euro,
- klasës katastrale III dhe IV është 45 euro,
- klasës katastrale V dhe VI është 30 euro dhe
- klasës katastrale VII dhe VIII është 15 euro, në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë të paguar në ditën e pagesës.

Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi gjeografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë gjeografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

**VIII. DORËZIMI I OFERTËS**

Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) mund të merret në Ministrinë e bujqësisë, pyltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Njësitë periferike të Ministrisë dhe në ueb faqen e Ministrisë, dhe i njëjti duhet të plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të parashtrohet me dokumentacionin e nevojshëm në zarf të mbyllur, në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.

Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur në të cilin në këndin e epërm të majtë duhet të qëndrojë shenja *"mos hap"* **-** *"Ofertë e shpalljes publike nr. 02/17 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqet mbi 3 hektarë dhe përmes ankandit publik elektronik për rajonin (shkruhet rajoni/tërësia gjeografike)* dhe në mes "**Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup**" në afat prej 60 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë tjetër me të cilën do të mund të identifikohet ofertuesi, gjegjësisht dërguesi.

**Ofertat e dorëzuara sipas kësaj shpallje publike nr. 02/17 do të hapen publikisht në ditën e parë duke llogaritur nga dita e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.**

**Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të mbledhjeve në Ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2, Shkup me fillim në ora 10.**

**IX. INFORMATAT PLOTËSUESE**

Për informatat plotësuese ofertuesit mund të drejtohen deri në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në numrin e telefonit: **02 313 44 77** ose të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk

**MINISTËR,**
**Lupço Nikollovski**

**IPSH ENTI GERONTOLOGJIK – 13 NOEMVRI – SHKUP**
rr. 4 juli 129 Shkup; tel.++389 2 2031-238; faks: ++389 2 2041-461; e-mail: info@gerontology.org.mk
BDS 4063902 NTP 4030997139926

Në bazë të nenit 156,157,158,159 dhe 160 të Ligjit për mbrojtke shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Kumtesës së Ministrisë së financave të RM nr. 18-7080/2 të datës 03.08.2017 për shpallje si të vlefshme ( Pëlqimin për mjetet e siguruara financare për punësimet të dhënë nga ana e Ministrisë së financave me numër 18-70975/2 të datës 01.08.2016 për nevojat e IPSH Enti Gerontologjik "13 Noemvri" – Shkup shpallet si e vlefshme në pjesën në të cilën nuk është realizuar edhe gjatë vitit aktual 2017) dhe Vendimit për publikim të Shpalljes nr. 03-1975 të datës 04.08.2017 nga ana e U. D Drejtorit të IPSH Enti Gerontologjik "13 Noemvri" – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin e punëtorëve shëndetësor, një (1) Doktor të medicinës, dy (2) motra medicinale dhe një (1) laborant për kohë të pacaktuar.

1. IPSH Enti Gerontologjik "13 Noemvri" – Shkup ka nevojë për punësimin e punëtorëve shëndetësor një (1) doktor të medicinës për punë në Repartin Hospis Sju Rajder – Manastir, dy (2) motra medicinale dhe një (1) laborant për punë në Shkup për kohë të pacaktuar.

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Doktor të medicinës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Arsim të mbaruar sipëror (VII/1) ose 240 kredi sipas SETK – Fakulteti i medicinës,
- Provim të dhënë profesional
- Licencë për punë
- Njohje të një prej gjuhëve të huaja botërore (angleze, frënge, gjermane)
- Njohje të punës me kompjuter
- Me dhe pa përvojë pune

4. Orari javor i punës është 40 orë – me ndërrime, neto pagesa bazë për Doktor të medicinës është 26.583,oo denarë.

6. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Motër medicinale duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Arsim të mesëm të medicinës motër medicinale (PMP – shkalla IV)
- Njohje të punës me kompjuter
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune

7. Orari javor i punës është 40 orë – me ndërrime, neto pagesa bazë për Motër medicinale është 16.814,oo denarë.

9. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Laborant duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Arsim të mesëm mjekësor Laborant medicine (PMP - shkalla-IV)
- Njohjen e punës me kompjuterë
- Të dhënë provimin profesional
- Me dhe pa përvojë pune

10. Orari i punës javore është 40 orë, pagesa neto bazë për Laborant është 16.814,00 denarë.

12. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për **Doktor të medicinës Доктор на медицина** janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar (nëse është marrë jashtë vendit të nostrifikuar nga Ministria e arsimit)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dokument për njohje të një prej gjuhëve botërore (angleze, frënge, gjermane), origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dokument për njohje të punës me kompjuterë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

13. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për **Motër medicinale Медицински сестри** janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar apo certifikatë/dëftesa për arsim të mbaruar nga të gjitha vitet, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dokument për njohje të punës me kompjuterë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

14. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët **Laborant** janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar apo certifikatë/dëftesa për arsim të mbaruar nga të gjitha vitet, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dokument për njohje të punës me kompjuterë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

15. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

17. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

19. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3 të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provimi kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore dhe për kandidatët e paraqitur nga pika 5 dhe pika 7 të cilët përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet pjesa profesionale (test) në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

21. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në Arkivin e IPSH Enti Gerontologjik "13 Noemvri" – Shkup prej ora 08-15,00 ose përmes postës në adresën " 4 Juli" nr. 129 – Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Enti Gerontologjik "13 Noemvri" – Shkup

---

Në bazë të nenit 155- b, 155- v, 156, 157, 158, 159, 160, 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-7084/2 të datës 03.08.2017, vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-1282 të datës 03.08.2017 dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr 0401-1283 të datës 03.08.2017 U. D Drejtori i IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për punësim të 1 (një) farmaceuti të diplomuar dhe 1 (një) teknologu të radiologjisë për kohë të pacaktuar

1. IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup ka nevojë për punësim të:
1.1 1 (një) farmaceut të diplomuar për kohë të pacaktuar dhe
1.2 1 (një) teknolog të radiologjisë për kohë të pacaktuar.

2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
-të jetë shtetas i RM,
-të jetë i moshës së rritur,
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
-të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin e dhe **kushtet e posaçme** në vijim**:**

**Për kandidatët nën pikën 1.1**
-arsim të mbaruar sipëror me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i farmacisë
-provim të dhënë profesional
-licencë për punë
-sukses të arritur mesatar prej të gjitha lëndëve nga të gjitha ciklet të studimeve universitare që ka mbaruar kandidati prej së paku tetë ( në tekstin e mëtutjeshëm: suksesi mesatar) dhe
-në mënyrë aktive të njeh një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, gjermane ose frënge) të nivelit B2 sipas Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim të gjuhëve, mësim dhe vlerësim (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtutjeshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.
-me dhe pa përvojë pune.

Njohja e gjuhës së huaj nga pika 3 e kësaj shpallje publike, përveç certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohet edhe me vërtetim për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të ranguara në Shanghai Ranking - ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidati posedon diplomë të nostrifikuar.

**Për kandidatin nën pikën 1.2**
- arsim të mbaruar sipëror nga sfera e medicinës me së paku 180 kredi të arritura sipas SETK,
- certifikatë për njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane) të nivelit A1.
- provim të dhënë profesional
- me dhe pa përvojë pune.

4. Orari i punës është prej 40 orëve në javë dhe neto pagesë bazë:
- Për kandidatin nën pikën 1.1 është 24.743,00 denarë.
- Për kandidatin nën pikën 1.2 është 21.250,00 denarë.

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar që të parashtrojnë dokumentet në vijim

**Për kandidatin nën pikën 1.1**
-fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
-biografi të shkurtë (CV)
-Diplomë me sukses mesatar
-Njohja e gjuhës së huaj dëshmohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Goethe-Zertifikat, TestDaF dhe
BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të nivelit B2 të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim të gjuhëve mësim dhe vlerësim (CEFR).
-Kandidatët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e medicinës në një prej 100 fakultetet më të mirë të ranguara të Shanghai Ranking-ARWU (Academik Rankinking of World Universities) nuk kanë nevojë të përmbushin kushtet e posaçme nga pika 3 e kësaj shpallje, as edhe për punësimin e tyre realizohet procedurë për selektim të kandidatit.
-certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

**Për kandidatët nën pikën 1.2**
- fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar
- certifikatë për njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) të nivelit A1.
- dëshmi për provim të dhënë profesional (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- dëshmi për përvojë të punës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

7. Dokumentacioni i vonuar, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

8. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për farmceut të diplomuar dhe teknolog radiologjik të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e plotë të nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohen deri në IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, ndërsa me mbishkrim për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup
U. D Drejtor
D-r Igor Kuzmanovski



Murinjo është trajner i shkëlqyer, por nuk kam pasur shumë raporte të mira me të. Ajo çfarë dua është t'ju dëshmoj se jam lojtar i mirë dhe se Mançester Junajtedi gaboi që më lëshoi



Pas Mançester J. – Real Madrid, edhe një spektakël në Shkup

# Shkëndija pret gjigantët e AC Milan

**Kuqezinjtë nga Tetova fituan “xhek pot” duke fituar për kundërshtar gjigantin nga Italia AC Milan, ndërsa gjiganti turk Fenerbahçe do të jetë kundërshtari i Vardarit. Të dyja skuadrat, por edhe ajo e Skënderbeut që do të luan ndaj Dinamo Zagrebit, do të kërkojnë të plasohen në grupet e Liga Evropës**





*Shkup, 4 gusht* – Shkupi do të jetë qendra e futbollit në muajin gusht. Pas evenimentit më të madh atij të Superkupës që do të zhvillohet më 8-të gusht në “Telekom Arena” ndërmjet Mançester Junajtedit dhe Realit të Madridit, më 17 gusht përsëri në “Telekom Arena” do të zbarkon njëra prej ekipeve më të mëdha të futbollit evropian dhe atij botëror si dhe 7 herë fituesi i trofeut në Ligën e Kampionëve, AC Milan e përbërë nga yjet e futbollit si Donnarumma, Bonuçi, Xhalhanoglu, Andre Silva,Biglia dhe të tjerë. Kështu u vendos dje në shortin e hedhur në Nion të Zvicrës për ndeshjet e plej ofit të Liga Evropës. Kuqezinjtë nga Milano do të jenë mysafir i KF Shkëndija nga Tetova, në kuadër të plej-of për plasman në Liga Evropë. Për dallim nga ndeshja e fundit e Milanit ndaj Krajova ku nuk luajtën disa titullarë, pritet të trajneri Vinçenco Montella të mos eksperimentojë me formacionin dhe në Shkup të vjen me formacionin e tij më të mirë. Vlen të përmendim se deri më tani Milani, ku pronar janë kinezë, kanë harxhuar rreth 200 milionë euro për përforcime duke filluar nga Rodriguez, Musakio, Bonuçi, Konti, Kesi, Biglia, Xhalhanoglu, Borini dhe Andre Silva. Të jemi të sinqertë vështirë të flasësh për një kualifikim përballë një skuadre që vetëm këtë verë ka shpenzuar mbi 200 milionë euro, vetë përballja me Milanin për Shkëndijën është një çmim i jashtëzakonshëm, një shpërblim për skuadrën dhe tifozët e saj “Ballistët”, një shpërblim për sponsorin Lazim Destani dhe “Ecolog” falë mbështetjes së të cilit Shkëndija po bëhet e madhe dhe në Evropë. Një çmim për gjithë lojtarët që në kthim në datën 24 gusht do të provojnë emocionet e gjigandit “San Siro”. Derisa edhe një skuadër e njohur në Evropë, Fenerbahçe do të zbarkojë në Shkup, ku po në të njëjtin stadium do të përballet me kampionin aktual të Maqedonisë, KF Vardar. Ndërkohë, Skënderbeu do të përballet me Dinamon e Zagrebin. Një kundërshtar me të cilin u ndeshën edhe në para dy vitesh në plej-of të Ligës së Kampioneve. Ndeshja e parë luhet në Zagreb, ndërsa kthimi në “Elbasan Arena”.

**HASI KUNDËR ZHUTËS, EJUPI NDAJ AUSTRIA VJENËS**

Besnik Hasi dhe skuadra e Olimpiakosit në fazën e plej-ofit të Ligës së kampionëve do të përballen me kroatët e Rijëkës, pjesë e së cilës është futbollisti shqiptar Leonard Zhuta dhe maqedonasi Stefan Ristovski. Ndryshe, Karabagu dhe Agolli do të luajnë përballë danezëve të FC Kobenhavn, Napoli i Elseid Hysajt do të përballet me francezët e Nice ku aktivizohet Mario Balotelli, pastaj Bashakshehir i Sokol Cikalleshit të ndeshet me Seviljën, në një duel ku spanjollët nisen si favoritë. Ndërkohë, Jang Bojsi i Taulant Seferit do të ndeshet me CSKA-në e Moskës. Sa i përket Liga Evropës, Osijeku i sulmuesit shkupjan Muzafer Ejupi dhe mesfushorit kosovar Eros Grezda do të përballet me Austrin e Vienës, ndërsa Legia Varshava ku luan sulmuesi Armando Sadiku do të luan ndaj Sherif Triaspolin.

**VINÇENCO MONTELLA (trajner i Milanit)**

“Na është bërë zakon shorti, ishte argëtuese të marrim pjesë drejtpërdrejt. Nuk e njoh mirë skuadrën (Shkëndijën), kemi kohë ta studiojmë. Po mundohemi ta dimë ku është vendi ku do të luajmë lojën si mysafir





## Inter Turku shkarkoi Kuqin

Trajneri kosovar, Shefki Kuqi, është shkarkuar nga skuadra finlandeze, Inter Turku, ka bërë të ditur të enjten kryetari i klubit elitar të Finlandës, Board Stefan Hakans. "Nuk është e lehtë dhe e mirë të ndërrohet trajneri. Bordi i klubit nuk kishte më besim në Shefki Kuqin dhe nuk na mbeti zgjidhje tjetër", ka thënë Hakans për uebfaqen zyrtare të klubit. Rolin e trajnerit të parë do ta marrë ndihmësi i Kuqit, italiani Fabrizio Piccarreta. Kuqi 40-vjeçar u shkarkua për shkak të rezultateve të dobëta. Inter Turku zë vendin e tetë pas 19 ndeshjeve të zhvilluara me 24 pikë.

## Shkupi humb miqësoren me Liburnin

*Shkup, 4 gusht* – Skuadra e “Liburnit”, e cila është kampione e Kosovës në futsall, ka mundur me 5:3 kampionin e Maqedonisë Shkupi në kuadër të ndeshjes miqësore, e cila u zhvillua në palestrën sportive “Shani Nushi” në Gjakovë. Ndeshja e cila u cilësua si vëllazërore, ishte shumë e bukur me aksione dhe raste të shumta shënimi, ku në fund skuadra kosovare iu gëzua fitores. Për të dyja ekipet kjo ndeshje shërbeu si përgatitje për ndeshjet e UEFA “Futsal Cup”.



Ndërkohë, nga klubi kosovar njoftuan se janë në bisedime që të zhvillojnë edhe një ndeshje tjetër miqësore, por kësaj radhe në Shkup. “Me shumë mundësi në fund të javës apo në fillim të javës tjetër, ka mundësi të zhvillohet edhe një ndeshje tjetër miqësore në Shkup”, thonë nga klubi kosovar. (B.K.)



## Islami në botërorin e atletikës në Londër

*Shkup, 4 gusht* – Dje pasdite në Londër ka filluar kampionati i 16-të botëror i atletikës. Në parkun olimpik deri më 13 gusht atletët më të mirë botëror do të bëjnë gara për të marrë titullin e kampionit të botës. Në qendër të interesimit do të jetë largimi zyrtar i kampionit aktual botëror Usain Bolt. Eliminatoret në këtë botëror nisin dje në vrapin e 100 metrave, ndërsa të shtunën do të zhvillohen garat finale në të cilat për herë të fundit do të paraqitet Usain Bolt. Ndryshe, Maqedonia në këtë botëror të atletikës do të ketë vetëm një përfaqsues. Drita Islami si përfaqësuese e Maqedonisë, do të bëjë gara në vrapin e 400 metrave dhe paraqitja e saj nis nga garat eliminatore.

## Bushati: Po bëjmë gjithçka ta pengojmë ekstradimin e Ballistit në Serbi

Ballist Morina ndodhet në shtetin kroat duke pritur nëse do të ekstradohet apo jo. Ndërsa ministri i jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati deklaron se shteti shqiptar ka bërë gjithçka për të penguar ekstradimin e Ballist Morinës për në Serbi. Në lidhje me kërkesën e tij për azil politik në Kroaci, ai u shpreh se edhe në këtë rast mund të përdoret precedent i Italisë ku u kërkua ekstradimi i tij nga Serbia çka u refuzua nga shteti italian, shkruan “Lapsi.al”. Kryediplomati shqiptar komenton edhe marrëdhëniet mes Serbisë dhe Shqipërisë ku në mes është edhe çështja e Ballist Morinës, ministri Bushati i cilëson si një tryeze shahu ku secila palë bën lojën e vet. Ballist Morina u arrestua nga autoritetet kroate për shkak se nga ana e shteti serb ekziston një urdhër arresti ndërkombëtar dhe tashmë pritet vendimi i gjykatës për ekstradimin e tij. Ballist Morina u bë i njohur për lëshimin e dronit në ndeshjen Serbi-Shqipëri në Beograd, ndeshjen e cila u ndërpre për shkak të dhunës së ushtruar ndaj futbollistëve shqiptarë.



Republika e Maqedonisë
**Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave**

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës s Maqedonisë" nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë më herët nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 01/17 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 100/17), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon:

## SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/17
## Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektar

**I. LËNDË E SHPALLJES PUBLIKE**
Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **866 ha 75 ar 56 $m^2$** edhe atë për rajonet në vijim në Republikën e Maqedonisë:

| Nr. rend | Rajoni | Ha | Ar | $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Negotinë | 5 | 80 | 77 |
| 2 | Berovë | 171 | 14 | 80 |
| 3 | Probishtip | 105 | 69 | 42 |
| 4 | Kisella Vodë | 56 | 85 | 15 |
| 5 | Kërçovë | 22 | 56 | 35 |
| 6 | Prilep | 504 | 69 | 07 |
| **GJITHSEJ** | | **866** | **75** | **56** |

Të dhënat për tokën bujqësore nga kjo shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përmbajtura në listën pronësore) janë në pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilën sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësinë periferike të Ministrisë ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.
Toka bujqësore në pronësi të shtetit e cila jepet me qira me këtë shpallje publike është me qëllim të:
-ngritje të mbjellave shumëvjeçare (vreshta, pemishte, hmel) dhe oranzheri për periudhë deri në 30 vjet,
- ngritje të mbjellave shumëvjeçare me lajthi për periudhë deri në 70 vjet,
-ngritje të ullishtave për periudhë deri në 50 vjet,
- kultivimit të kulturave të tjera bujqësore për periudhë deri më 15 vjet,
-livadhe për periudhë deri në 15 vjet,
-për kultivimin e drujve që rriten shpejtë në tokën bujqësore që gjendet në lartësi mbidetare mbi 700 metra, për periudhë deri në 30 vjet,
-basene të peshqve deri në 20 vjet dhe
-aktivitete sportive-rekreative dhe turizëm rural deri në 30 vjet.

**II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE**
Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.
Subjektet fizike duhet të jenë realizues të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.
Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.
Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore tu jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.
Personat e lidhur në kuptim si persona të lidhur juridikisht, persona fizik të lidhur, person i lidhur fizik me person juridik dhe indirekt persona të lidhur në person juridik kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike dhe mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për pjesëmarrje.
Të drejtë pjesëmarrjeje në shpalljen publike kanë personat të cilat nuk kanë të lidhur asnjë marrëveshje ekzistuese për qira marrje me Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.

**III. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE**
Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënien me e tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira të hapësirave deri në 3 hektarë në shoqërim të fletëparaqitjes duhet të dorëzojnë:
**a) për subjektet juridike:**
- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);
- dëshmi (akt) të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik;
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
-dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për punimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter);
- vërtetim nga Njësia periferike e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;
-deklaratë të dhënë me gjithë përgjegjësinë materiale dhe penale se oferta bëhet e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe që është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për tokë bujqësore, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave juridik, persona të lidhur fizik, person fizik i lidhur me person juridik ose indirekt persona të lidhur në subjekt juridik;
- deklaratë të vërtetuar në noter për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në fletëparaqitjen për pjesëmarrje;
- biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin e të punësuarve, aspektet e tregut, pritshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose nga personi i autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizimit të vërtetuar në noter);
-deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përmbushur obligimet nga ajo marrëveshje.
**b) për personat fizik:**
- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);
-dëshmi se janë paguar obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontributeve në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim të detyrueshëm social;
- dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për punimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).
- fotokopje të letërnjoftimit;
- vërtetim për regjistrim në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore, vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga regjistri qendror për regjistrim si tregtar i vetëm;
- program për shfrytëzimin e tokës e cila përmban të dhëna bazë për familjen, pajisjen tekniko-teknologjike, qëllimi për të cilin shfrytëzohet toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);
- deklaratë për besueshmëri të të dhënave të paraqitura me fletëparaqitjen e vërtetuar në noter;
- vërtetim nga Njësia rajonale e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;
-deklaratë të dhënë për përgjegjësi materiale dhe penale se oferta paraqitet si e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe e cila është në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave të lidhur juridik, personave të lidhur fizik, person fizik me person juridik ose indirekt persona të lidhur në person juridik dhe
-deklaratë të vërtetuar në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës në personin juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe e cila nuk i ka plotësuar detyrimit nga ajo marrëveshje.
Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të plotësohet tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme, në të kundërtën oferta **nuk do të merret parasysh**.

**IV. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTUESUT MË TË VOLITSHËM**
Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm në procedurë të shpalljes publike për dhënien e tokës bujqësore në pronësi të shtetit deri në 3 hektarë, bëhet në përputhshmëri me Rregulloren për kriteret më të afërta për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit e cila mund të jepet me qira dhe përcaktim të madhësisë së hapësirës së tokës bujqësore e cila mund të jepet me qira ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/08, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15 dhe 129/15), edhe atë në bazë të kritereve vijuese:
- largësia nga vendbanimi, respektivisht qëndrimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike– 65 pikë.
- qiramarrja e ofruar vjetore për hektar– 25 pikë.
- statusi juridik i ofertuesit– 10 pikë.
Kriteri largësi nga vendi i jetesës, respektivisht vendbanimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike do të thotë se largësia nga vendi i jetesës, respektivisht selia e ofertuesit në raport me parcelën kadastrale që shpallet ndodhet në komunë të njëjtë kadastrale dhe notohet me numër maksimal të pikëve. Nëse ofertues është njësi e e ndonjë personi vendor juridik merret parasysh qëndrimi i personit juridik i cili e ka themeluar filialin.
Kriteri qiramarrja e ofruar vjetore për hektar vlerësohet në bazë të formulës– qiramarrja e ofruar vjetore për hektar e ndarë me qiramarrjen më të madhe vjetore për hektar, të shumëzuar me numër maksimal të pikëve që mund të fitohen në bazë të këtij kriteri ku:
S=(P/Pmaks) x 25
S – numri i pikëve
P – qiraja e ofruar
Pmaks – qiraja më e lartë e ofruar
Kriteri statusi juridik i ofertuesit fitohet me numër maksimal të pikëve për ofertues që është kryerës i regjistruar i veprimtarisë bujqësore ose i siguruar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor si bujk individual, tregtar individual ose subjekte juridike që përmbushin kushtet nga neni 24 i Ligjit për tokë bujqësore.
Sipërfaqja maksimale për të cilën mund të aplikojë një ofertues nuk mund të jetë më e madhe se 3 hektarë, as më e vogël madhësia e një parcele katastrale gjegjësisht blloku.

**V. ÇMIMI FILLESTAR**
Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës.
Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike për sipërfaqe deri në 3 hektar është 25 euro në kundërvlerë denar për tokën bujqësore të klasës katastrale prej I deri në IV dhe 15 euro në kundërvlerë denarë për tokën bujqësore të klasës katastrale prej V deri në VIII, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.
nëse toka bujqësore gjendet në rajonin malor, çmimi fillestar i tokës së klasës katastrale prej I deri në IV do të jetë 15 euro, ndërsa për tokën prej klasës V deri në VIII do të jetë 5 euro në kundërvlerë denarë, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.
Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi gjeografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë gjeografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

**VI. FORMULARI PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE (OFERTA)**
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) mund të merret në Ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, njësitë rajonale të Ministrisë dhe nga ueb faqja e Ministrisë dhe i njëjti duhet të plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të dorëzohet me dokumentacionin e nevojshëm në zarf të mbyllur, në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.
Ofertat të cilat nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm, të dorëzuar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, ofertat të cilat dorëzohen pas skadimit të afatit për parashtrim, zarf të shënuar me të cilën do të mund të identifikohet ofertuesi, ofertat më të ulta nga shuma më të ulta të qirasë vjetore, parashtrohen nga persona që nuk kanë të drejtë të parashtrojnë oferta, si dhe ofertat e përpiluara jo në jo sipas kushteve të caktuara në shpalljen publike, hidhen si të pakompletuara.
Ofertuesi i cili nuk është i kënaqur nga zgjedhja realizuar në lidhje me shpalljen publike mund që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, të ngritë procedurë para gjykata e rregullt e autorizuar.
**Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se**:
- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;
- janë parashtruar pas kalimit të afatit për parashtrim;
- të parashtruara me zarf të shënuar me çka do të mund të identifikohet ofertuesi;
- janë parashtruar nga persona që nuk kanë të drejtë të parashtrojnë oferta dhe
- nuk janë përpiluar sipas kushteve të përcaktuara në shpalljen publike **komisioni do t'i hedhë si të pakompletuara**.
Oferta e cila do të parashtrohet me qira të ofruar më të ulët se qiraja minimale e përcaktuar me Ligj për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë **si të palejuar**.
Ofertat e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit në lidhke me thirrjen publike **nuk do të shqyrtohen**.
Kushtet e parapara në biznes plan (për subjektet juridike), gjegjësisht aspektet e tregut (tek subjektet fizike) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime të kontraktuara që do të jenët ë obliguar t'i përmbushë në kapacitetin, afatet dhe mënyrën që do të përshkruhen në shpalljen publike.
Secili ofertues mund të parashtrojë vetëm një ofertë origjinale për pjesëmarrje në shpalljen publike me dokumentacionin e nevojshëm nga pjesa II e kësaj shpallje publike.
Marrëveshja për qira të lidhur me ofertuesin e zgjedhur më të volitshëm futet në fuqi me ditën e futjes në pronësi të qiramarrësit mbi tokën bujqësore lëndë e marrëveshjes nga ana e qiradhënësit edhe atë vetëm për sipërfaqet për të cilat është dhënë në pronësi faktike.

**VII. DORËZIMI I OFERTËS**
Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm parashtrohen në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e epërme të majtë duhet të shënojë "*mos hap" "Ofertë në sipas Shpalljes publike 01/07 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqe deri në 3 hektarë sipas rajonit (shënohet rajoni)* dhe në **mes *"Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup"*** në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetat durore.
Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që do të mund të identifikojë ofertuesin, gjegjësisht dërguesin.
**Ofertat e parashruara në lidhje me këtë shpallje publike nr. 01/17 do të hapen publikisht në ditën e tretë të punës duke konsideruar nga dita e fundit për parashtrim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.**
**Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të takimeve në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti" nr. 2 Shkup me fillim në ora 10.**

**VIII. INFORMATA PLOTËSUESE**
Për informata plotësuese ofertuesit mund të kontaktojnë në Ministrinë e Bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në njësitë rajonale, të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk ose në Sektorin për regjistrim dhe menaxhim me tokë bujqësore në telefonin: **02 313 44 77**.

**MINISTËR,**
**Lupço Nikollovski**

INSTITUTI PUBLIK SHKENCOR PËR GJUHË MAQEDONASE
"KRSTE MISIRKOV"
Nr.______________
SHKUP

Në bazë të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për zgjedhje në titull më të lartë shkencor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/09), Statutin e IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, nenin 56 dhe Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, nenit 14 në IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, Drejtoresha e IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, ka sjellë vendim për publikim të

KONKURSIT
Për punësim të:

Bashkëpunëtorit shkencor nga sfera e historisë së gjuhës maqedonase (një realizues)

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme nga Ligji për marrëdhënie pune, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim nga Ligji për veprimtari shkencore-hulumtuese, Statuti i IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup dhe Rregullorja për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup edhe atë: të ketë të mbaruar arsimin sipëror nga sfera e gjuhës maqedonase (VII/1), sukses të arritur mesatar të studimeve prej së paku tetë dhe të tregojë aftësi për hulumtim shkencor.

Dokumentet e nevojshme: certifikatë të shtetësisë, certifikatë të lindjes, CV (biografi të shkurtë dhe bibliografi), diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar sipëror nga sfera e gjuhës maqedonase (VII/1), cikël të dytë të mbaruar nga shkencat filologjike nga sfera e historisë së gjuhës maqedonase dhe doktoraturë të mbrojtur nga shkencat filologjike të sferës së historisë së gjuhës maqedonase..

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin e IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, personalisht osepërmes postës në adresën: rr. "Grigor Përliçev" nr. 5, 1000 Shkup.

Konkursi zgjatë pesë ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë**
**PUBLIKON**

Kërkesën për dhënie të Lejes për hulumtime të detajuara hidrogjeologjike me qëllim të realizimit të puseve. Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14 dhe 146/15), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është parashtruar Kërkesë për dhënie të Lejes për hulumtime të detajuara hidrogjeologjike me qëllim të realizimit të puseve, të parashtruar nga ana e Birrarisë së Prilepit SHA Prilep, UP 1 nr. 11/5-961/2017

**Parashtrues i kërkesës:**
Birraria e Prilepit SHA Prilep
Komuna e Prilepit

Lokacioni konkret shtrihet në PK nr. 20662/1 KK Çaçarica me koordinatat në vijim të hapësirës hulumtuese të dhënë përmes locimit të tyre të bazës së azhurnuar gjeodezike, sipas Gaus Kriger me sipërfaqe të përgjithshme prej P=1752m2:

| Pika | Koordinata x | Koordinata y |
|---|---|---|
| T-1 | 4 577 039 | 7 546 497 |
| T-2 | 4 576 962 | 7 546 544 |
| T-3 | 4 576 952 | 7 546 527 |
| T-4 | 4 577 029 | 7 546 480 |

Informacione në lidhje me kërkesën, opinioni i interesuar mund të marrë në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në e-mail adresën k.zekiri@moepp.gov.mk. Opinioni i tanguar në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës ka të drejtë të parashtrojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18, ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

INSTITUTI PUBLIK SHKENCOR PËR GJUHË MAQEDONASE
"KRSTE MISIRKOV"
SHKUP

Në bazë të Statutit të IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup dhe në bazë të Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup nenit 8 paragrafi 2 pika 2 dhe nenit 19, drejtoresha e IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, ka sjellë vendim për publikim të

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të:

Administratorit për studime postdiplomike (një realizues)

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme nga Ligji për marrëdhënie pune, Statutit të IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup dhe në bazë të Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup duhet të përmbushë edhe kushtet në vijim edhe atë: të ketë të mbaruar arsimin sipëror fakulteti juridik (VII/1), së paku dy vjet përvojë pune dhe provim të dhënë të jurisprudencës.

Dokumentet e nevojshme: certifikatë të shtetësisë, certifikatë të lindjes, CV (biografi të shkurtë dhe bibliografi), diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar sipëror fakulteti juridik (VII/1) dhe provim të dhënë të jurisprudencës.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin e IPSH Instituti për gjuhë maqedonase "Krste Misirkov" – Shkup, personalisht osepërmes postës në adresën: rr. "Grigor Përliçev" nr. 5, 1000 Shkup.

Konkursi zgjatë pesë ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Komuna e Tearcës
Nr.. 10 – 730 / 10
04.08..2017
Tearcë

## SHPALLJE E B - LEJËS SË INTEGRUAR EKOLOGJIKE

**Kryetari i komunës së Tearcës solli Vendim për dhënie të B - lejes së integruar ekologjike për SHPNTSH " BAU – ENN" shpk eksport – import f. Tearcë Reparti punues " BAU – ENN" shpk eksport – import f. Tearcë**

Leja është në disponim për publikun gjatë kohës së ditëve të punës në periudhën prej orës 8:00 – 16:00 në zyrën nr. 4 kati 1 në ndërtesën administrative të komunës së Tearcës , f. Tearcë, 1224 Tearcë.

Ankesat në lidhje me Vendimin mund të parashtrohen në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes , deri te komisioni i shkallës së dytë në rr. " Goce Dellçev " P.N. Shkup.

Të gjitha informatat e nevojshme mund të merren në tel. 044 381 336 ose në ueb faqen: www.tearce.gov.mk.

**Kryetari i Komunës**
**Isen Asani**

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dellçevë publikon:

**KORRIGJIM TË SHPALLJES PUBLIKE**
Për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të caktuar me kohëzgjatje prej 1 viti në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dellçevë nr. 04-405/3 të datës 31.07.2017

Në Shpalljen publike për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të caktuar me kohëzgjatje prej 1 viti në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dellçevë nr. 04-405/3 të datës 31.07.2017, të publikuar më datë 03.08.2017 në gazetat ditore Slloboden Peçat dhe Koha bëhet korrigjim edhe atë:

Në titull dhe në paragrafin 9 fjalët "prej 1 viti" zëvendësohen me fjalët "deri më 31.12.2017".

**IP QENDRA NDËRKOMUNALE PËR PUNË SOCIALE DELLÇEVË**

Në bazë të nenit 131 dhe 136 të Ligjit për arsim sipëror dhe nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, ndërsa në lidhje me vendimin e Këshillit mësimor-shkencor dhe bashkëpunues të Fakultetit për art dramaturgjik në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, dekani i Fakultetit shpall

**KONKURS**
Për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sfera e arteve të dramaturgjisë, edhe atë nga sferat (disiplinat) në vijim të hulumtimit:

1. **Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, nga sfera e arteve të dramaturgjisë, dega Regjia e televizionit dhe filmit, për lëndën:**
   - **Regjia e televizionit dhe filmit.**
2. **Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, nga sfera e arteve të dramaturgjisë, dega Teatrologjia, për lëndën:**
   - **Fjalim skenik me teknikë të zërit**
3. **Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, nga sfera e arteve të dramaturgjisë, dega Teatrologjia, për lëndën:**
   - **Lëvizje dhe vallëzime skenike**

**Kushtet:** Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, si dhe akteve tjera të Universitetit.
Së bashku me fletëparaqitjen kandidatit duhet të parashtrojnë: biografi, dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, certifikatë për shtetësi.
Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi".
Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e posaçëm dorëzohen në UKIM Fakulteti për arte të dramaturgjisë në Shkup rr. "Rugjer Boshkoviq" nr. 22 Shkup.

**UKIM Fakulteti për arte të dramaturgjisë**
**Shkup**

Organizata Humanitare "Ogranok na MIHO" Tetovë në bazë të vendimit numër 203-5819-38 të datës 25/07/2017 bën Shpalljen Publike për ndërmarrjet që merren me rruajtjen, rritjen dhe tregtinë me kafshë të imta ose të mëdha që sipas traditave rajonale të vendit tonë, mund të përdoren dhe janë të përshtatshme për Kurban në ditën e festës së Kurban Bajramit 2017.
Sipas kësaj, të gjitha subjektet juridike që e kryejnë veprimtarinë në fjalë, duhet që të dërgojnë ofertat e tyre me shkrim edhe atë për

1. Kafshë të imta – DELE me madhësi mesatare ..........................Çmimi për kokë
2. Kafshë të imta – DESHE me madhësi mesatare ........................ Çmimi për kokë
3. Kafshë të imta – DHI me madhësi mesatare ............................. Çmimi për kokë
4. Kafshë të imta – CJAP me madhësi mesatare .......................... Çmimi për kokë
5. Kafshë të mëdha – LOPË me peshë mbi 300 kgr ....................... Çmimi për kgr /pesha e gjallë
6. Kafshë të mëdha – MUZETËR me peshë mbi 300 kgr............... Çmimi për kgr/peshe e gjallë

Ofertat duhet të jenë me shkrim dhe të dërgohen me rekomandim në adresën e Organizatës humanitare në Tetovë deri më datë 4/08/2017 dhe sipas Ofertave të pranuara, komisioni zgjedhore do bëjë përzgjedhje të ofertës më të mirë dhe më të përshtatshme, për të cilën gjë Kompania fituese do jetë e lajmëruar me kohë që të përgatitet edhe nënshkrimi i kontratës me firmën fituese.
Kushtet tjera të përgjithshme që duhet të plotësohen nga ana e Kompanive që do dorëzojnë Ofertat janë :
Në çmimin e ofruar për secilëndo qoftë pikë të shpalljes, kompanitë duhet të përfshijnë edhe
- transportin,
- therjen e kurbaneve,
- përgatitjen për therje,
- paketimin,
- copëtimin e mishit,
- vendosjen nëpër qese me Logon e Organizatës,
- distribuimin deri te shfrytëzuesit e këtij Projekti nëpër qytetet e Republikës me mjete transporti me frigo, sipas orarit të përgatitur nga ana e organizatës dhe datave te caktuara paraprakisht gjatë ditëve të Kurban Bajramit

Adresa e organizatës Humanitare është Rr K. J. Pitu 99 Tetovë. Tel për kontakt 044/332-554
Ofertat e dërguara pas afatit te caktuar, nuk do merren parasysh gjatë vendosjes së ofertës me të mirë.

TETOVË 01/08/2017 Nga Drejtoria

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ( Ga zyrtare në RM 62/05, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013 и 113/2014), Rregullorja për organizim të punës dhe sistematizimit në vendet e punës dhe Pëlqimi i kryetarëve të komunave të Ohrit dhe Strugës , UD Drejtori i NPN Proaqua Strugë paraqet:

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për pranim të të punësuarve në afat të pacaktuar kohe**

NPN Proaqua NJP Ujësjellës Ohër ka nevojë për:
1. Punëtor i përgjithshëm PMP, KU 3 ( tre) përmbarues;

NPN Proaqua Strugë , NJP Ujësjellës dhe kanalizim Strugë ka nevojë prej:
1. Punëtor i përgjithshëm PMP, KU 3 ( tre) përmbarues;

Për të gjithë vendet e punës, kandidatët në shtojcë të lutjes duhet të dorëzojnë dëshmi për arsimin e kryer në origjinal ose kopje të verifikuar tek noteri.
Të punësuarit do të punojnë prej orës 07:00 deri 15:00 . Orari i punës javor është 40 orë . Punësimi është në afat të pacaktuar kohe.
Shuma monetare në neto page do të jetë :
Nr.r. 1- 13.500 denarë
Afati i paraqitjes është prej 5 ditësh nga dita e paraqitjes së shpalljes publike.
Afati në të cilën sillet Vendimi për zgjidhje varet nga numri I i kandidatëve sipas vendeve të punës, në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 nga LMP
Për vendet e punës në NJP Ujësjellës Ohër kandidatët lutjet t'i dorëzojnë në arkivin e NJP Ujësjellës Ohër në rr. Naum Ohridski p.n. Ohër në afat prej 5 ditësh nga dita shpalljes së konkursit.
Për vendet e punës në NJP Ujësjellës dhe kanalizim Strugë kandidatët lutjet t'i dorëzojnë në arkivin e NJP Ujësjellës dhe kanalizim Strugë në rr. Kej 8 –të Nëntori p.n Strugë në afat prej 5 ( pesë) ditësh nga dita e shpalljes së konkursit.
Lutjet e pa kompletuara dhe jo në kohë të dorëzuara nuk do të shqyrtohen .

**U.D Drejtor në NPN Proaqua Strugë**

**Shitet banesë tredhomëshe në katin përdhese me sipërfaqe 74 m2 në rr. Boro Menkov.**
**Kontakt telefoni 078 271 009 dhe 075 405 507**



Mateo Kovaçiç mund të rikthehet në Serie A. "Corriere dello Sport" ka zbuluar se Juventusi është duke kërkuar mesfushorin e Real Madridit. Përveç kroatit, në listën e klubit janë edhe Goretzka dhe Matuidi



Nejmar prezantohet si futbollist i PSZH

# Mezi po pres të luaj dhe ti arrij objektivat që dua

**"Mezi po pres që të filloj stërvitjet me bashkëlojtarët e mi të rinj. Mezi po pres që të luaj ndeshjet dhe sigurisht të arrij objektivat që dua", u shpreh Nejmar**

Edhe copëza e fundit ka shkuar në vendin e vet: Nejmar është zyrtarisht një lojtar i Paris Sen-Zhermenit. Futbollisti brazilian është prezantuar dje si futbollist i PSZH në një konferencë për shtyp. Cekim, Nejmar ka nënshkruar një kontratë prej 5 vitesh me vlerë prej 222 milionë euro, duke u bërë kështu futbollisti më i shtrenjtë në botë. Ai ka pranuar se ka qenë një vendim i vështirë për t'iu bashkuar skuadrës franceze. "Ishte një prej vendimeve më të vështira që kam marrë, isha te një klub i madh, Barcelona, e dua Barcelonën, kam miq të shumtë në atë klub. Ata janë lojtarë të mrekullueshëm, nuk ishte e lehtë për mua. Isha shumë i tensionuar, më duhej të mendohesha dhe të rimendohesha përsëri se çfarë dua të arrij në jetën time", u shpreh Nejmar. "Kam lënë shumë shokë të mirë prapa, por ky është futbolli, gjërat ecin me shpejtësi në futboll.




Dua të falënderoj të gjithë miqtë e mi te Barcelona, por ndjej se ishte koha e duhur për t'u larguar dhe për të provuar diçka të re", shtoi më tej ylli brazilian. "Mezi po pres që të filloj stërvitjet me bashkëlojtarët e mi të rinj. Mezi po pres që të luaj ndeshjet dhe sigurisht të arrij objektivat që dua", përfundoi tanimë futbollisti i ri i PSZH, Nejmar. Ndërkohë, hapi i ardhshëm pas prezantimit zyrtar do të bëhet sot (e shtunë) në orën 15:45 kur publiku në "Parc des Princes" pak para fillimit të ndeshjes së kampionatit kundër Amiens do ta shohin nga afër yllin e tyre të ri Nejmar.



## Hazard zëvendësuesi i Nejmarit?

Eden Hazard është në njëri nga të preferuarit e Barcelonës. Pas largimit të Nejmarit drejt Paris Sen-Zhermenit për një shifër prej 222 milionë eurove, Barcelona ka filluar menjëherë "gjahun" për të siguruar zëvendësuesin e tij. Sipas mediumit "Don Balon", ylli i Çellsit, Hazard mund të transferohet në Barcelonë si pasardhës i brazilianit. Reprezentuesi belg ka qenë prej kohësh një objektiv për Real Madridin, por thuhet se Hazard është i gatshëm të shkojë në "Camp Nou" për t'u bërë zëvendëses i Nejmarit. Në rast transferimit, Barcelona do të duhet t'i paguajë Bluve të Londrës së pakur 100 milionë euro.

## Mor do t'i bashkohet Napolit ose Romës



Emre Mor "do të bashkohet me Napolin ose Romën gjatë dy ditëve të ardhshme", ka thënë agjenti i anësorit turk të të Borussia Dortmundit, duke injoruar kështu interesimin e skuadrës tjetër italiane, Fiorentinës. Anësori i talentuar turk ishte i lidhur ngushtë me një kalim në klubin Viola, por duket se ata janë refuzuar nga Mor, duke zgjedhur një skuadër tjetër nga Serie A. Në vend të kësaj, Roma përballet me konkurrencë të vërtetë nga Napoli i Maurizio Sarri për nënshkrimin e tij dhe këtë e konfirmon agjenti i futbollistit. "Emre do të shkojë në Itali", ka thënë fillimisht agjenti Mustafa Ozxhan për "Ajansspor". "Ne u takuam me Napolin dhe Romën, kështu që gjatë dy ditëve të ardhshme gjithçka do të bëhet e qartë. Ai do të bashkohet me njërin nga këto dy klube", përfundoi agjenti i Emre Mor. Çmimi i talentit turk besohet të jetë rreth 20 milionë euro.

## Dortmundi refuzon Arsenalin për Dembelen

Kjo ishte e papritur! Arsenali këtë verë duket se ka bërë një ofertë për mesfushorin e Dortmundit, Ousmane Dembele, por është refuzuar. Lajmi vjen nga e përditshmja sportive spanjolle "El Mundo Deportivo", sipas së cilës trajneri Arsen Venger është i magjepsur nga 19-vjeçari. Pavarësisht deklaratave se Aleksis Sançez nuk do të largohet nga Londra, "Topçinjtë" janë të vetëdijshëm se gjithçka mund të ndodhë dhe po përgatiten për çdo skenar të mundshëm. Sulmuesi kilian nuk ndihet rehat në "Emirates Stadium", sepse do të luajë në Çampions Ligë. Dembele me të vërtet nuk është një golashënues si 28-vjeçari, por luan në krah dhe do t'i sillte shumë dinamikë dhe ide lojës së Arse-



nalit. Përveç londinezëve, interes për mesfushorin francez ka shprehur edhe PSZH-ja, por përgjigjja e Dortmundit ka qenë e njëjta: "jo". Në Spanjë, ndërkohë, ai po "programohet" si pasues i brazilianit Nejmar.

## Kondogbia kërkon largimin nga Interi

Geoffrej Kondogbia thuhet se ka kërkuar të largohet nga Interi, të cilët kërkojnë rreth 30 milion euro për shërbimet e mesfushorit. Sipas "Gazzetta dello Sport", Kondogbia beson se ai ka nevojë për një ndryshim të skenës pas dy viteve të vështira në Itali, ku ka shënuar vetëm dy gola në 56 paraqitje. Pavarësisht se u përforcua nën urdhrat e Luçiano Spallettit, autogoli i tij nga distanca kundër Çellsit ishte "një shenjë tjetër e një martese të pafat" mes tij dhe Interit. 24-vjeçari gjithashtu kërkon futboll të rregullt, kështu që ai mund të thirret në skuadrën e Francës për Kupën e Botës verën e ardhshme, edhe pse ai



nuk ka luajtur për 'Les Bleus' që nga shtatori 2015. Gazeta thotë se Interi do të kërkojë një pagesë në rajon prej 25-30 milionë eurosh, pasi ka paguar 40 milionë euro për ta nënshkruar me atë dy vjet më parë. Nerazzurrët kanë nevojë për të fituar të holla, pasi po përpiqen të mbledhin fonde për një transferim të madh këtë verë, ku më i përfoluri është lojtari i Bajern Munihut, Arturo Vidal.

Sipas mediumit italian 'ofertat më interesante' për Kondogbian priten të vijnë nga klubet e Ligës Premier.

## Shkurt

### Murinjo mendon Bejllin

Mançester Junajted janë gati të paguajnë afro 100 milionë euro për Geret Bejll. Sipas mediave britanike, Hose Murinjo është gati të bëjë goditjen e madhe në merkato. Trajneri i "Djajve të Kuq" po monitoron me kujdes situatën e uellsianit, menjëherë pas lajmit se Reali i Madridit është gati ta shesë Bale për ti hapur rrugën blerjes së 18-vjeçarit Kylian Mbappe nga Monako.

### Perishiç dhe Kandreva nuk largohen

Drejtori sportiv i Interit, Piero Ausilio ka këmbëngulur se Antonio Kandreva dhe Ivan Perishiç nuk do të largohen nga klubit, Xhejson Murillo është larg nga Valencia dhe nuk ka asnjë shans për Arturo Vidalin. Udhëheqësi i 'merkatos' së Nerazzurrëve ka folur për mediumin "Mediaset Premium" mbrëmjen e së enjtes dhe ka sqaruar situatat e disa nga historive të nxehta të transferimeve. "Nuk e kuptoj se nga vijnë disa nga këto histori", ka thënë fillimisht drejtori sportiv i Interit për 'Mediaset Premium". "Kandreva nuk ka qenë kurrë në treg dhe nuk kemi absolutisht asnjë qëllim për ta shitur atë. E njëjta gjë vlen për Perishiç, i cili është një lojtar i rëndësishëm dhe ne jemi duke diskutuar një kontratë të re me të", përfundoi Ausilio.

### Juve do Gomezin, Barca lëviz për Dybalan

Andre Gomes përfundon në shënjestër të Juventusit. Bardhezinjtë kanë zgjedhur mesfushorin e Barcelonës si përforcim të mundshëm në rast se nuk arrijnë dot te Matuidi. Gjithsesi te Barcelona nuk dëshirojnë të privohen lehtësisht nga portugezi për të kërkon jo më pak se 40 milionë euro. Gjithsesi te Barcelona mund të nisin negociatat nisur edhe nga interesimi i klubit katalanas për Dybalan me Barcelonën që ka nisur të lëvizë për argjentinasin menjëherë pas largimit te Nejmar.

### Palasio në bisedime me Bolonjën

Ish-sulmuesi i Interit, Rodrigo Palasio është në prag të nënshkrimit të Bolonjës së Roberto Donadonit. Palasio i njohur ndryshe si 'La Trenza' është futbollisti i lirë pasi kontrata e tij me Nerazzurrët ka skaduar këtë verë. Sipas "Gazzamercato.it", Palasio dhe agjenti i tij janë në negociata të avancuara me Bolonjën për një marrëveshje të re. Argjentinasi 35-vjeçar ka qenë në Itali që nga viti 2009 në Xhenoa, pastaj u transferua te Interi në vitin 2012. Ai gjatë këtyre viteve shënoi 74 gola në 230 ndeshje të luajtura në Serie A.

### Negredo zyrtarizohet te Beshiktashi

Sulmuesi spanjoll i ka dhënë lamtumirën Valencias. Alvaro Negredo nga dita e enjte është një futbollist i Beshiktashit pas aritjes së marrëveshjes mes dy klubeve. Valencia komunikoi se ka arritur akordin me klubin e Beshiktashit për shitjen përfundimtare të sulmuesit spanjoll, që sezonin e kaluar luajti në huazim te Midëllzboro. Negredo ka nënshkruar kontratë tre-vjeçare me kampionët e Turqisë.

### Uilliams i mbyll derën Interit

Inaki Uilliams i premton besnikëri Atletik Bilbaos edhe për shumë vite të tjera duke shuar në këtë mënyrë shpresat e Interit që është prej kohësh në ndjekje sulmuesit 23-vjeçar.

Inaki Uilliams deklaroi se është i përqendruar vetëm te puna me skuadrën baske ku dëshiron të qëndrojë edhe për shumë kohë, duke shtuar se spekulimet e merkatos nuk nxiten nga ai apo stafi që e menaxhon

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për sigurim shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12,145/12,87/13,39/14,10/15,154/15,192/15,17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave e RM nr. 18-7094/2 nga data 03.08.2017, dhe Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës të IPSH Enti për medicinë fizikale dhe rehabilitim-Shkup, Drejtori i IPSH Enti për medicinë fizikale dhe rehabilitim-Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM

1. Publikohet shpallje publike për punësimin e punëtorëve shëndetësorë, në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar
- Motër medicinale 1 (një) realizues, të mbaruar arsim sipëror – motër medicinave e diplomuar

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësore:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Motër medicinale duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të ketë të mbaruar arsim të lartë për motër medicinale
- Të dhënë provimin profesional
- Me dhe pa përvojë pune
- Njohjen e një nga tre gjuhët më të shfrytëzuara në Unionin evropian (angleze, frënge, gjermane) në nivel A1

6. Orari i punës javore është 40 orë –me ndërrime, pagesa neto bazë për Motër medicinale të diplomuar është 21.500,00 denarë.

7. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Diplomë apo certifikatë për arsim të lartë të mbaruar për Motër medicinale, me suksesin mesatar për çdo vit, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Për Motër medicinale Certifikatë për njohjen e një nga tre gjuhët më të shfrytëzuara në Unionin evropian (angleze, frënge, gjermane) në nivel A1.

10. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit.
11. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
12. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3 dhe pika 5 të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 nga Ligji për sigurim shëndetësore edhe për kandidatët e paraqitur nga pika 7 të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet pjesa profesionale (test) në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 nga Ligji për sigurim shëndetësore.
13. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në IPSH Enti për medicinë fizikale dhe rehabilitim-Shkup, Elisije Popovski Marko nr.28 Shkup me postë apo në arkivin e IPSH Enti për medicinë fizikale dhe rehabilitim-Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Enti për medicinë fizikale dhe rehabilitim-Shkup

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave nr. 04-1098/7 nga data 04.08.2017, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04-1098/8 nga data 04.08.2017, u.d. Drejtori i IPSH Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup, publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**

**për punësimin 2 (dy) motra medicinale me kohë të pacaktuar**

1. IPSH Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup, ka nevojë për punësimin e:
   - 2 (dy) motra medicinale me kohë të pacaktuar
2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e **posaçme në vijim**:
   - Të mbaruar arsim të mesëm medicinal – motër medicinale (PMP – shkalla e IV);
   - provim të dhënë profesional;
   - me dhe pa përvojë pune
4. Orari i punës 40 orë në javë dhe neto pagesa bazë::
   - është 19.300,00 denarë
5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) për motër medicinal edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi për përvojë pune (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);
6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve
8. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës dhe motër medicinale të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup rr. "Vodnjanska" nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup

Në bazë të nenit 156, 157 paragrafi 1, alineja 1, 158, 159 dhe 160 të Ligjit për sigurim shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave nr. 18-10970/2 nga 01.08.2016 dhe nr. 18-7082/2 të datës 03.08.2017, ushtruesi i detyrës së drejtorit të IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për punësimin e punëtorëve shëndetësore për kohë të pacaktuar

DOKTOR MEDICINE...................................................................................2 (dy) realizues

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DOKTOR TË MEDICINËS
- Të jetë shtetas i RM
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

KUSHTET E POSAÇME PËR DOKTOR TË MEDICINËS
- Të ketë të mbaruar arsim të lartë (VII/1) apo 240 kredi sipas SETK-Fakulteti Mjekësisë,
- Provim të dhënë profesional,
- Licencë për punë,
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj botërore (angleze, gjermane ose frënge).
- Me dhe pa përvojë pune.

DOKUMENTACION I NEVOJSHËM PËR DOKTOR TË MEDICINËS
- Fletëparaqitje (domosdo numër telefoni për kontakt),
- Biografi të shkurtë,
- Certifikatë të shtetësisë,
- Kopje të letërnjoftimit ose të certifikatës së lindjes,
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë nga gjykata kompetente se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Diplomë ose certifikatë për Fakultet të mbaruar të medicinës (prej ku mund të shihet mesatarja e suksesit), në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Nostrifikim të diplomës për kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Dokument për ekuivalencë të notave të dhënë nga Ministria e arsimit dhe shkencës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Deklaratë për njohje të gjuhës së huaj.

Selektimi i kandidatëve të **punëtorit shëndetësor me arsim sipëror** bëhet në bazë të kritereve në vijim:
1. mesatare të suksesit që kandidati e ka arritur në institucionin për arsim sipëror që bartë 40 pikë dhe
2. provim kualifikues i përbërë prej dy pjesëve që bartë gjithsej 60 pikë, edhe atë:
- pjesa profesionale (test) që bartë 40 pikë dhe
- njohje të një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane ose frënge) që bartë 20 pikë.

Orari i punës është me ndërrime, 40 orë në javë, pagesa do të paguhet sipas Marrëveshjes kolektive për veprimtari shëndetësore të Republikës së Maqedonisë, në shumë prej 23.431,00 denarë.

Afati për paraqitje në shpallje është shtatë (7) ditë pune nga dita e publikimit, ku si ditë e parë e publikimit konsiderohet dita e publikimit të fundit në shpallje publike.

Kandidati i cili përmbushë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter i dorëzon në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli ose si dërgesë me postë në adresën IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli, me shenjë "për shpallje".

IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli

Në bazë të neneve 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për sigurim shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pajtueshmërinë për punësim nga Ministria e financave numër 18-7095/2 të datës 03.08.2017, Vendimi për publikim të shpalljes publike nr. 04-1719/1 të datës 04.08.2017 nga u.d Drejtor i IPSH Spitali i përgjithshëm Strumicë, publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për punësim të 10 (dhjetë) motra medicinale dhe 1 (një) fizioterapeut – masazhist për kohë të pacaktuar**

1. IPSH Spitali i përgjithshëm Strumicë ka nevojë për punësimin për kohë të pacaktuar :
   1.1. 10 (dhjetë) motra mediciale për kohë të pacaktuar,
   1.2. Një (1) fizioterapeut – masazhist për kohë të pacaktuar,

2. Për vendin e punës nën pikën 1.1 motër medicinale. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor :
- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe **kushtet e posaçme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor:
   - Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës – motër medicinale (PMP – shkalla e IV)
- Provim të dhënë profesional
4. Orari javor i punës është 40 orë me ndërrime dhe neto pagesa bazë 16.424,00 denarë.
5. Së bashku me fletëparaqitjen si dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
-dëshmi për arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (SHMM) për motër medicinale edhe atë dëftesat e të gjitha 4 (katër) viteve ku është shënuar suksesi që është arritur në SHMM për secilin vit (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
-Dëshmi për provim të dhënë profesional (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
6. Për vendin e punës nën pikën 1.2 fizioterapeut – masazhist. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor
- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
7. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe **kushtet e posaçme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor
- Arsim të mesëm të mbaruar për fizioterapeut – masazhist
- Provim të dhënë profesional
8. Orari javor i punës është 40 orë me ndërrime dhe neto pagesa bazë 16.424,00 denarë
9. Së bashku me fletëparaqitjen si dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme të parashtrojnë dokumentet në vijim
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- dëshmi për arsim të mesëm të mbaruar për fizioterapeut edhe atë dëftesat e të gjitha viteve ku është shënuar suksesi që është arritur për secilin vit (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi për provim të dhënë profesional (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
10. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
11. Dokumentacioni jo në kohë, i pakompletuar dhe pa rregulluar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
12. Pas selektimit të realizuar me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për sigurim shëndetësor.
13. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm të nevojshëm, të dorëzohen deri te IPSH Spitali i përgjithshëm Strumicë, rr."Mlladinska nr.2" me postë ose në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Strumicë me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Spitali i përgjithshëm Strumicë

# Dyfishohet numri i femrave që vuajnë nga taket e larta

Rastet e dhimbjes së fortë në mes të gishtave të këmbëve, e quajtur nevroma e Mortonit, ose neuralgjia interdigjitale, është rritur në mesin e femrave prej 40-69 vjeçare për 115 për qind që nga viti 2004, sipas të dhënave të qendrës britanike të informimit rreth shëndetit dhe shërbimeve sociale.



Femrat janë dhjetë herë më të ndjeshme ndaj këtij problemi sesa meshkujt, sepse besohet se atë e shkaktojnë shumë vjet të shfrytëzimit të këpucëve me take të larta apo të këpucëve joadekuate. Nevroma e Mortonit e prekë nervin në mes të gishtave të këmbëve, zhvillohet indi fijor i cili e shtyp nervin dhe shkakton dhimbje. Personat që e kanë këtë gjendje e përshkruajnë atë si një varg të ndjenjave të pakëndshme nga ndjesia e të pasurit një gur të vogël në këpucë, e deri tek dhimbja e krahasueshme me ecjen nëpër zhileta. Ortopedi dhe studiuesi Andrew Craig nga spitali në Bedford thotë se i ka studiuar 40 pacientë dhe se më shumë se gjysma duhej t'i nënshtroheshin operacionit. "Nevroma e Mortonit është një fenomen historikisht i dokumentuar mirë, por i shpjeguar dobët të cilit mund t'i qasemi në disa mënyra. Prej kohësh e dimë se kryesisht e pësojnë femrat në moshën e mesme, ndërsa spekulohet se shkaku janë taket e larta dhe këpucët e ngushta dhe të panatyrshme, pa marrë parasysh se sa të bukura duken ato", tha ai. Përveç operacionit, çregullimi mund të trajtohet me shtresa të veçanta dhe injeksione steroide. Përmes operacionit herët apo vonë hiqet i gjithë nervi i shtypur, dhe pacienti nuk ka më ndjesi në mes të gishtave.

# Mbijeton edhe pas 40 minutave pa puls

Një njeri nga Karolina e Veriut në Amerikë, John Ogburn, pësoi sulm në zemër teksa po punonte ë laptop afër shtëpisë së tij në Charlotte. Dy oficerë policor që qëlluan afër,filluan t'ia japin ndihmën e parë babait të tri fëmijëve, shkruan BBC. Ata dy nuk pushuan së provuari që ta rikthejnë në jetë 36 vjeçarin për 42 minuta derisa iu rikthye pulsi. Oficerët e Charlotte, Lawrence Guiler dhe Nikolina Bajic dhe përpjekjet e tyre meritore edhe pas 20 minutash, për ta shpëtuar David, ndonëse nuk kishin parë asnjë shenjë vitale, ishin ato që morën vëmendjen më të madhe. Pasi që ishte sjellur në spital, Ogburn u vu në komë artificiale për ta ndihmuar që të rikuperohet për pjesën tjetër të javës. Ai është këshilluar që të mos vozisë për gjashtë muaj dhe të kthehet lehtë në punë.



# Sa është e rrezikshme kërcitja e gishtave

Disa thjesht nuk jetojnë pa i kërcitur gishtat. Të tjerët nuk e durojnë këtë gjë. Në fillim të këtij viti, shkencëtarët kanë zbuluar se nga vjen zhurma kur kërcasim gishtat. "Është pak a shumë si krijimi i një vakumi. Kur shkëputen sipërfaqet papritmas, nuk ka lëng të pranishëm për të zënë vendin bosh. Kështu që krijohet një zgavër," thonë shkencëtarët. Sipas tyre, momenti i krijimit të zgavrës sjell edhe zhurmën. Në një takim të Shoqatës së Radiologëve Amerikanë u fol sërish për këtë çështje, transmeton Klan Kosova. Radiologu Robert D. Boutin i Universitetit të Kalifornisë tha se ka bërë një studim të detajuar të zgavrave me anë të ultratingujve. "Ajo që pamë ishte si një dritë. Ishte si një fishekzjarr që shpërthen. Ishte diçka krejt e pazakontë". Sipas shkencëtarëve, blici vjen direkt pas zhurmës. Kjo mbështet edhe teorinë e zgavrës. Por a është e rrezikshme? Një studim tek një 60-vjeçar që kërciste gishtat zbuloi se gishtat e tij janë bërë më të lëvizshëm- por vetëm për një periudhë të shkurtër kohore. Sipas shkencëtarëve, kërcitjet nuk i kanë sjellë ndonjë dëm në shëndet.



# Hani hudhra dhe qepë për jetë të gjatë

Konsumimi i rregullt i qepëve dhe hudhrave do të përmirësojë mrekullisht imunitetin tuaj, ndihmon në parandalimin e kancerit dhe ruan shëndetin optimal të zemrës. Hudhra është antibiotik natyral i fuqishëm dhe ka veti të forta antibakteriale. Gjithashtu, hudhra ka veti të fuqishme antiinflamatore që mund të ndihmojë kundër inflamacionit kronik, infeksioneve bakteriale dhe dhimbjeve të ndryshme. Qepët dhe hudhrat rregullojnë gjithashtu nivelin e kolesterolit. Ato janë të pasura me squfur që parandalon krijimin e tepërt të kalciumit dhe yndyrës në enët e gjakut. Kjo rezulton në një përmirësim të qarkullimit të gjakut. Ngrënia e rregullt e hudhrave dhe qepëve do të rrisë imunitetin tuaj dhe do t'iu mbrojë nga ftohjet dhe gripi. Gjithashtu, kanë efekt të fuqishëm në "luftën" kundër kancerit. Qepa dhe hudhra kanë ushqyes që mbrojnë nga kanceri i zorrës së trashë, veshkave, mitrës dhe vezoreve. Komponimet antibakteriale dhe antivirale të gjetura në hudhër dhe qepë mbrojnë trupin nga "sulmuesit" e jashtëm. Të dyja perimet janë të disponueshme gjatë gjithë vitit, prandaj mos ngurroni të përfshini ato në regjimin e përditshëm ushqimor.



## KALENDARI HISTORIK 5 GUSHT

1100 - Henri I kurorëzohet si Mbret i Anglisë në Westminster Abbey.
1305 - William Wallace, udhëheqësi i rezistencës skoceze ndaj Anglisë, zihet afër Glazgovit dhe transportohet në Londër për gjykim dhe ekzekutim.
1391 - Masakrohen hebrenjtë në Toledo dhe Barcelonë të Spanjës.
1543 - Trupat franceze dhe turke okupojnë Nicën.
1716 - Beteja e Petervardenit: Eugjen van Savoje mund turqit.
1772 - Ndarja e parë e Polonisë mes Austrisë, Prusisë dhe Rusisë.
1890 - Britanikët dhe francezët merren vesh për të ndarë kolonitë afrikane.
1914 - Kuba, Uruguai, Meksika dhe Argjentina shpallin neutralitet gjatë Luftës së I Botërore.
1921 - Traktati i Berlinit: SHBA dhe Gjermania nënshkruajnë traktat të paqes.
1945 - Hidhet bomba atomike në Hiroshima.
1964 - SHBA fillon bombardimin në Vietnamin Verior.

## A E DINI SE...



Franklin D. Roosevelt është i vetmi President i SHBA-ve që ishte President më shumë se 8 vjet dhe njëri nga më me ndikimin të madh në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Një zemër normal i ka të rrahurat 72 herë në minutë! Kjo do të thotë që 100.000 herë në ditë, apo 3.600.000 në vit! Zemra e gjinisë femërore është 25% më e vogël se ajo e gjinisë mashkullore.




E-mailet spam konsumojnë 33miliard KWh energji elektrike brenda një viti, energji kjo e cila do të mjaftonte për të furnizuar plot 2.4 milionë shtëpi.

## BARSOLETA

### DITARI I NJË GRUAJE

Në ditarin e një gruaje që kishte udhëtuar me anije shkruante…
- E Martë, është dita e tretë e udhëtimit në anije. Sot mu afrua kapiteni i anijes dhe po më vardiset…
- E Mërkurë, kapiteni i anijes më ftoi për drek në kabinën e tij…
- E Enjte, kapiteni i anijes kërkoi që ta kalojë natën me mua…
- E Premte, kapiteni i anijes m'u kërcënua se nëse nuk pranoj të fle me të do ta fundosi anijen me gjithë 387 pasagjerët…
-E Shtunë, i shpëtova 387 pasagjerët nga anija jonë!

## THËNIA E DITËS

Mosha nuk ka rëndësi, nëse nuk je djathë. (Billie Burke)

